

UDHËZUES PËR FILLIMIN E VITIT SHKOLLOR 2020–2021

(Në ndihmë të drejtuesve, mësuesve, prindërve dhe nxënësve të institucioneve arsimore parauniversitare)



Udhëzues për fillimin e vitit shkollor 2020-2021

Gusht, 2020

Tiranë

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	2
PJESA E PARË.....	5
1 HYRJE.....	7
2 PROCESI I HARTIMIT TË UDHËZUESIT	9
3 PLANIFIKIMI I KURRIKULËS - HARTIMI I TEMAVE MËSIMORE	11
4 SKENARËT PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT MËSIMOR PËR VITIN SHKOLLOR 2020-2021	13
4.1 Skenari 1	14
4.1.1 Skenari 1.1	14
4.1.2 Skenari 1.2	14
4.1.3 Skenari 1.3	16
4.2 SKENARI 2	19
4.2.1 Skenari 2.1	19
4.2.2 Skenari 2.2	19
4.2.3 Skenari 2.3	20
4.3 SKENARI 3	22
5 MASAT E SIGURISË DHE TË HIGJENËS.....	23
5.1 Hyrje	23
5.2 Kujdesi për nxënësin.....	23
5.2.1 Hyrja dhe dalja nga ambientet e shkollës.....	23
5.2.2 Qëndrimi dhe mësimi në klasa.....	24
5.2.3 Lëvizjet në mjediset e brendshme të shkollës.....	24
5.2.4 Kujdesi për higjienën	25
5.3 Kujdesi për mësuesin	26
5.4 Kujdesi për personelin ndihmës.....	26
5.4.1 Sanitare	26
5.4.2 Rojë e institucionit/oficeri i sigurisë.....	27
5.5 Kujdesi për prindin	27
5.6 Kujdesi për drejtuesit.....	27
PJESA E DYTË.....	29
6 UDHËZIME ORGANIZATIVE PËR DRAP-ET, ZVA-TË DHE SHKOLLAT.....	31
6.1 Udhëzime për DRAP/ZVA-të.....	31
6.2 Udhëzime për shkollat.....	33
6.2.1 Duke u bazuar në vendimet dhe në udhëzimet e MASR- së, në varësi të variantit që do të zbatohet, secila shkollë:	33

6.2.2	Udhëzime specifike për shkollat, lidhur me realizimin me sukses të mësimit në distancë (online) në rast të zbatimit të skenarëve që e përmbajnë këtë formë mësimi.	34
6.3	Udhëzime specifike për punonjësit e shërbimit psiko-social	36
6.4	Udhëzime specifike për oficerët e sigurisë në shkollë	39
7	UDHËZIME METODOLOGJIKE	40
7.1	Udhëzime të përgjithshme metodologjike	40
7.2	Udhëzime metodologjike për secilin skenar	42
8	UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE	46
8.1	Vlerësimi i nxënësve në skenarin 1	47
8.2	Vlerësimi i nxënësve në skenarin 2	49
8.3	Vlerësimi i nxënësve në skenarin 3	51
8.3.1	Varianti 1	55
8.3.2	Varianti 2	56
8.3.3	Varianti 3	57
9	NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA.....	59
10	VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR, PROVIMET KOMBËTARE PËR ARSIMIN BAZË DHE MATURA SHTETËRORE.....	61
11	MBËSHTETJA DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE, DREJTUESVE DHE PJESËS TJETËR TË STAFIVE ARSIMORE.....	62
12	MBËSHTETJA DHE KOMUNIKIMI ME PRINDËRIT	64

PJESA E PARË

TABELA E PËRMBAJTJES

-HYRJE

-PROCESI I HARTIMIT TË UDHËZUESIT

-PLANIFIKIMI I KURRIKULËS - HARTIMI I TEMAVE MËSIMORE

-SKENARËT PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT MËSIMOR PËR VITIN SHKOLLOR 2020-2021

Skenari 1

SKENARI 2

SKENARI 3

-MASAT E SIGURISË DHE TË HIGJENËS

Hyrje

Kujdesi për nxënësin

Kujdesi për mësuesin

Kujdesi për personelin ndihmës

Kujdesi për prindin

Kujdesi për drejtuesit

1 HYRJE

Në të gjithë botën, qeveritë, ministritë e arsimit dhe shkollat janë duke u përballur me sfidat e fillimit të vitit të ri shkollor në një kohë shumë të pasigurt. Pas një ndërprerjeje të gjatë të procesit mësimor, vendet i kanë hequr gradualisht kufizimet, por duke përcaktuar masat mbrojtëse, veçanërisht distancën fizike. Me virusin ende në qarkullim në shkallë botërore, shoqëria po përgatitet për një “realitet të ri”, në të cilin arsimi mund të jetë i ndryshëm nga sa e kanë njohur nxënësit, mësuesit, prindërit dhe komuniteti.

Shkollat nuk janë vetëm vendi ku nxënësit marrin njohuri të reja në lëndë të ndryshme mësimore, por edhe ku zhvillohen nga ana sociale dhe emocionale. Mbyllja e tyre nuk ka penguar vetëm realizimin normal të procesit të të nxënësve, por edhe mbështetjen për mirëqenien psiko-emocionale të nxënësve. Për këtë arsye, sistemet arsimore në vende të ndryshme po planifikojnë disa skenarë për vitin e ri shkollor, me përparësi rihapjen e shkollave, por në varësi të përhapjes së virusit dhe të specifikave të shkollave edhe mësim në distancë ose kombinim të të dyja formave: mësim në shkollë dhe mësim në distancë.

I njëjti realitet paraqitet edhe në vendin tonë. Të gjithë duam që nxënësit tanë të kthehen përsëri në shkollë, pasi humbja e mësimave mund të ketë pasoja afatgjata për nxënësit, prindërit dhe të gjithë shoqërinë në aspektin social dhe ekonomik. Megjithatë do të ishte e papranueshme nëse nxënësit kthehen në shkollë dhe nuk do të ishin të sigurt nga ana shëndetësore. Në përmbushjen e kësaj sfide shkollat do të kenë mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe të të gjitha drejtorive dhe zyrave arsimore në nivel kombëtar dhe vendor. Pjesë e kësaj mbështetjeje është edhe hartimi i këtij udhëzuesi.

Udhëzuesi synon të kontribuojë në përgatitjen e shkollave që të jenë fleksibël në planifikimin dhe në organizimin e procesit mësimor, të përkushtuara për të ofruar arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, të gatshme për t'u ofruar nxënësve mjedise të sigurt duke respektuar rregullat e distancimit fizik dhe masat e tjera mbrojtëse, si dhe të afta për t'u përballur me pasojat e pandemisë COVID-19. Që shkolla ta përmbushë këtë synim, nevojitet planifikim, angazhim i të gjithë aktorëve në sistemin arsimor dhe rishikim e ndryshim i planeve në varësi të ecurisë së pandemisë.

Në udhëzues parashikohen tre skenarë të mundshëm të zhvillimit të procesit mësimor:

- 🔗 mësim në shkollë;
- 🔗 mësim i kombinuar (në shtëpi dhe në shkollë);
- 🔗 mësim në kushtet e shtëpisë (online).

Skenarët do të zbatohen në varësi të infrastrukturës së shkollave, të numrit të nxënësve dhe të përhapjes së virusit. Kështu mund të ndodhë që brenda një qyteti të ketë një shkollë që e zhvillon procesin mësimor normalisht dhe një shkollë që zbaton mësimin e kombinuar (shkollë dhe shtëpi), siç mund të ndodhë që një shkollë ta nisë procesin mësimor normalisht dhe më pas të vijojë me mësimin në kushtet e shtëpisë për shkak të përhapjes së virusit. Në sistemin tonë arsimor, si në çdo vend të botës, ka shkolla që mund të mundësojnë zhvillim normal të procesit mësimor, ka shkolla që mund të mos jenë në gjendje të

mirëpresin të gjithë nxënësit me kohë të plotë për shkak të zbatimit të rregullave të distancimit fizik dhe të masave të tjera mbrojtëse, ka shkolla që mund ta zhvillojnë mësimin me turne etj. Pavarësisht rrethanave dhe specifikave të tyre, shkollat do të sigurojnë:

- arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës;
- mirëqenie (shëndet mendor dhe mbështetje psiko-sociale) për nxënësit;
- mjedise të sigurta për nxënësit dhe për stafin mësimor dhe ndihmës.

Udhëzuesi orienton mësuesit dhe drejtuesit e shkollave publike dhe private, në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Planifikimi për organizimin dhe për zhvillimin e procesit mësimor gjatë vitit shkollor 2020-2021. Përshkrimi dhe zbatimi i skenarëve të mundshëm për organizimin e procesit mësimor.
- Zbatimi i masave të sigurisë dhe të higjienës sipas protokollit të autoriteteve shëndetësore.
- Udhëzime organizative për DRAP-et, ZVA-të dhe shkollat për fillimin e vitit shkollor.
- Udhëzime metodologjike sipas tre skenarëve, përfshirë edhe platformat online dhe videot që transmetohen në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH) për mësimin në distancë dhe të kombinuar.
- Udhëzime për vlerësimin e nxënësve sipas secilit skenar.
- Mbështetja e nxënësve me aftësi të kufizuara.
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me prindërit.
- Vlerësimi i Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor (VANAF), Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë (PKAB) dhe Matura Shtetërore (MSH). Programet orientuese për provimet kombëtare.
- Zhvillimi profesional i mësuesve, i drejtuesve dhe i personelit ndihmës në shkollë.

Pavarësisht përshkrimeve të detajuara dhe rekomandimeve të praktikave më të mira, udhëzuesi lejon fleksibilitetin që u nevojitet shkollave për të zhvilluar dhe për të zbatuar zgjidhje krijuese në përputhje me rrethanat e tyre specifike dhe lokale.

2 PROCESI I HARTIMIT TË UDHËZUESIT

Për shkak të pandemisë COVID-19, MASR u detyrua të mbyllë shkollat nga data 9 mars 2020 e deri në përfundim të vitit shkollor 2019-2020. Kthimi në shkollë u mundësua vetëm për maurantët pas datës 30 prill me qëllim përgatitjen e tyre për provimet e Maturës Shtetërore. Gjatë këtyre muajve, MASR mbështeti mësuesit në përpjekjet e tyre për të zbutur ndikimin e mbylljes së menjëhershme të shkollave, si dhe për të mundësuar vazhdimësinë e procesit mësimor përmes mësimi në distancë (mësimi në kushtet e shtëpisë).

MASR dhe ASCAP në bashkëpunim me organizatat, bizneset, shtëpitë botuese etj., mundësuan:

- hartimin e udhëzuesit për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimi në distancë dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020;
- hartimin e materialeve në ndihmë të mësuesve, nxënësve dhe prindërve;
- përgatitjen e videove mësimore në RTSH;
- rishikimin e programeve orientuese për provimet e Maturës Shtetërore;
- evidentimin dhe zgjidhjen e problematikave të mësimi në kushtet e shtëpisë;
- ofrimin e shërbimit psikologjik për nxënës;
- trajnimin e mësuesve për përdorimin e platformave online;
- sigurimin e pajisjeve digjitale për fëmijët nga shtresat në nevojë;
- hartimin e temave mësimore për të gjitha lëndët mësimore dhe për të gjitha klasat në arsimin parauniversitar;
- etj.

Në vazhden e kësaj mbështetjeje është edhe ky udhëzues. Hartimi i tij është një ndërmarrje e rëndësishme, për shkak të kompleksitetit të sistemit tonë arsimor dhe të ndikimit të pandemisë COVID-19. Puna ka nisur me:

- hulumtimin e përvojës botërore në lidhje me masat dhe me skenarët e mundshëm që vende të ndryshme kanë planifikuar për vitin shkollor 2020-2021;
- pjesëmarrjen e specialistëve të MASR-së dhe të ASCAP-it në takime online me kolegët e tyre në rajon dhe më gjerë, për të diskutuar rreth dokumenteve që kanë hartuar për rihapjen e shkollave;
- diskutimin e propozimeve të rrjetit të CIDREE¹, ku bën pjesë edhe ASCAP.

Më pas, janë organizuar takime dhe diskutime virtuale me drejtues dhe me specialistë të MASR-së dhe të DPAP-së, me ekspertë dhe me palë të interesuara nga fusha e shëndetit dhe e arsimit. Duke u bazuar në përvojën e vendeve të ndryshme dhe në analizën e gjendjes së shkollave tona (informacionet u mblodhën dhe u përpunuan nga DPAP) u përcaktuan skenarët e mundshëm për vitin shkollor 2020-2021. Bazuar në këta skenarë u hartua udhëzuesi për fillimin e vitit shkollor 2020-2021. Drafti i këtij udhëzuesi u diskutua me Këshillin Kombëtar të Arsimit, mësues, drejtues shkollash, prindër, nxënës, psikologë, ekspertë të arsimit dhe të shëndetësisë, pedagogë në universitete, sindikata, etj. Grupi i punës në ASCAP

¹ Consortium of Institutions for Development and Research in Education in Europe

sintetizoi kontributin e pasur dhe reflektoi të gjitha sugjerimet e aktorëve të mësipërm në udhëzues.

Grupi i punës në ASCAP gjatë hartimit të udhëzuesit ndoqi parimet e mëposhtme:

- Shëndeti, siguria dhe mirëqenia e nxënësve dhe e mësuesve në shkollë janë parësore.
- Barazia dhe gjithëpërfshirja duhet të udhëheqin çdo planifikim dhe çdo vendimmarrje.
- Ofrimi i udhëzimeve për shkollat është po aq i rëndësishëm sa dhënia e mundësive që ata të zhvillojnë zgjidhje të reja krijuese, në varësi të sfidave dhe të rrethanave të tyre.
- Inkurajimi i shkollave që të bashkëpunojnë me prindërit dhe me komunitetin për të zhvilluar dhe për të zbatuar strategji në përputhje me nevojat e tyre specifike. Suksesi do të arrihet vetëm falë përpjekjes kolektive të të gjithë aktorëve.

Hartimi i këtij udhëzuesi nuk do të jetë ndihma e vetme për shkollat gjatë këtij viti shkollor. Në varësi të situatës, do të ofrohen udhëzime, trajnime dhe materiale të tjera ndihmëse për mësuesit dhe për drejtuesit e shkollave.

3 PLANIFIKIMI I KURRIKULËS - HARTIMI I TEMAVE MËSIMORE

Situata e krijuar nga pandemia COVID-19 ka prekur çdo fushë të veprimtarisë në arsim dhe të gjithëve na është dashur të përshtatemi me këtë ndryshim të papritur. Për të pasur një koherencë ndërmjet të gjitha formave të mësimit dhe për t'i paraprirë zbatimin të çdo skenari në sistemin arsimor: mësimi në mjediset e shkollës, mësimi të kombinuar, mësimi në distancë online me platformë të dedikuar akademi.al, mësimet e transmetuara në RTSH, mësimet e transmetuara në kanalin youtube të MASR-së dhe mësimet përmes platformave të ndryshme që mundësojnë krijimin e klasave virtuale, ASCAP ka përgatitur një listë temash për secilën lëndë dhe për secilën klasë të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë që do të përdoret nga të gjithë mësuesit sipas profileve përkatëse.

Lista e temave për çdo lëndë dhe për çdo klasë është një radhitje e tyre sipas periudhave tremujore të caktuara në kurrikulën me kompetenca. Këtë listë temash secili mësues do ta pasurojë dhe do ta plotësojë me rubrikat e tjera, të përcaktuara në udhëzuesit kurrikularë, duke hartuar kështu planet vjetore dhe planet përkatëse të periudhave.

Lista e temave i përmbahet programit lëndor dhe përfshin të gjitha orët vjetore sipas planit mësimor të klasës përkatëse. *Në të gjitha lëndët dhe klasat gjatë dy javëve të para të shkollës janë planifikuar orë përsëritjeje për njohuritë kryesore të zhvilluara gjatë periudhës së mësimit në kushtet e shtëpisë (mars-maj 2020). **Temat e përsëritjes mund të ndryshojnë në varësi të specifikave që ka secili mësues lidhur me nevojat e nxënësve.***

Megjithëse temat e listuara do të përdoren nga të gjithë mësuesit, **ata janë të lirë të bëjnë ndryshime apo spostime në lidhje me orët e projekteve, orët e testeve, orët e vlerësimeve të portofolit etj., hap pas hapi në varësi të specifikave të lëndës së tyre dhe të nevojave të nxënësve.**

Procedura për hartimin dhe për dorëzimin e planeve vjetore dhe të periudhave do të jetë njësoj siç është parashikuar në udhëzuesit kurrikularë lëndorë, duke ruajtur radhitjen e temave mësimore.

Edhe gjatë vitit shkollor 2020 – 2021, planifikimi i mësimdhënies për lëndën përfshin:

-  planifikimin vjetor;
-  planifikimin për secilën periudhë;
-  planifikimin ditor.

Në fillim të vitit shkollor mësuesi do të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës *planin vjetor* të lëndës ose të modulit, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator- dhjetor). Temat mësimore janë të përcaktuara, ndërsa plani i periudhës do të pasurohet me rubrikat e mëposhtme.

Plani i periudhës	- Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç.
	- Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave lëndore.
	- Numri rendor
	- Kapitulli ose tematika
	- Tema mësimore (kjo rubrikë është plotësuar nga ASCAP, por mësuesi ka fleksibilitet për të ndryshuar ndonjë temë apo për ta spostuar).
	- Situata e të nxënit
	- Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
	- Vlerësimi
	- Burime

Planet e periudhës së dytë dhe të periudhës së tretë do të dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.


Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar te arritjet e kompetencave kyç dhe të lëndës.

4 SKENARËT PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT MËSIMOR PËR VITIN SHKOLLOR 2020-2021

Bazuar në të dhënat dhe në protokollet që janë përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale për situatën e pandemisë së shkaktuar nga COVID- 19, MASR në bashkëpunim me ASCAP-in dhe me institucione të tjera të varësisë kanë planifikuar disa skenarë për fillimin e vitit shkollor 2020 – 2021. Skenarët mund të jenë fleksibël sepse zbatimi i tyre në shkolla mund të varet nga situata lokale e pandemisë së COVID- 19 ose nga situata që mund të krijohen në shkolla të veçanta. Kjo nënkupton që të tre skenarët mund të zbatohen në të njëjtën kohë në të gjithë vendin, në varësi të situatave përkatëse të shkollave, qyteteve apo të vendit tonë. Disa shkolla mund të kombinojnë edhe variantet brenda një skenari në varësi të numrit të nxënësve që kanë në klasa.

KUJDES! Zbatimi i secilit skenar dhe variant të skenarit për çdo shkollë është vendim që do të merret nga MASR, bazuar në situatën e pandemisë, hap pas hapi gjatë gjithë vitit shkollor.

Shkollat, duke u bazuar në udhëzimet e MASR-së, do të përshtatin mësimin sipas variantit përkatës të skenarit që do të zbatohet. **Shkollat kanë fleksibilitet me oraret dhe modifikimin e varianteve në varësi të kushteve të tyre specifike.**



4.1 Skenari 1

Mësimi zhvillohet në mjediset fizike të shkollës, duke ruajtur të gjitha rregullat e higjienës dhe të distancimit fizik, nëse situata e pandemisë është e qëndrueshme².

4.1.1 Skenari 1.1

Shkollat me një turn, me numër të vogël nxënësish dhe që plotësojnë protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për higjienën dhe për distancimin fizik, zhvillojnë normalisht procesin mësimor.

Në këtë rast ora mësimore është 45 minuta. Institucionet që mund ta zbatojnë këtë variant, janë kryesisht institucione të arsimit fillor dhe të arsimit të mesëm të ulët në zona rurale ku numri i nxënësve për klasë është jo më shumë se 20 nxënës dhe ku mund të plotësohet ruajtja e distancimit fizik dhe e rregullave të higjienës. ***Në rast të kundërt klasa do të ndahet me grupe sipas rastit 1.2.*** Shumica e këtyre shkollave janë shkolla vartëse, janë shkolla në zona rurale dhe janë shkolla me klasa kolektive. Në këtë variant përfshihet 90% e klasave kolektive ku numri i nxënësve është i ulët dhe mundësia për të ruajtur distancimin fizik është e pranueshme. *Mësimi në këto shkolla do të zhvillohet normalisht (me orë mësimi 45 minuta dhe klasa të pandara në grupe) dhe nuk ka vështirësi në infrastrukturë apo vështirësi të lëvizjes së mësuesve.*

4.1.2 Skenari 1.2

Shkollat me një turn me numër të madh nxënësish, të cilat në mënyrën normale të funksionimit të tyre nuk plotësojnë protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për ruajtjen e higjienës dhe të distancimit fizik:

- ndërtojnë një grafik për hyrjen dhe për daljen e nxënësve që të shmangët grumbullimi i tyre, pa prekur orën e fillimit dhe të mbarimit të shkollës;
- ndajnë çdo klasë në dy grupe:
 - grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 8.00-11.15;
 - grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 11.45-15.00.

Ora e mësimi do të jetë 30 minuta. ***Mësimi do të zhvillohet me dy orë të njëpasnjëshme.*** Koha mësimore që i shtohet çdo mësuesi, është shtesë me afërsi 7 orë mësimi në javë, të cilat mund të paguhet si orë suplementare ose orët mësimore shtesë mund të realizohen me mësues shtesë.

Institucionet që mund ta zbatojnë këtë variant, janë kryesisht shkolla të arsimit të mesëm të ulët dhe shkolla të arsimit të mesëm të lartë në qytete, duke përfshirë edhe pjesën më të madhe të gjimnazeve dhe të shkollave jopublike, ku numri i nxënësve për klasë është mbi 20

² Situatën e pandemisë e përcakton Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale (MSHMS).

nxënës. Në ato raste kur numri i nxënësve për klasë është më pak se 20 nxënës, por nuk mund të ruhet distancimi fizik për shkak të madhësisë së klasës, klasa do të ndahet me grupe.

Disa shkolla mund të kombinojnë edhe variantet 1.1 dhe 1.2 brenda skenarit të parë, në varësi të numrit të nxënësve që kanë në klasa. P.sh., nëse klasat e arsimit fillor kanë numër të vogël nxënësish dhe mund të zbatohen rregullat e higjienës dhe të distancimit fizik mund të zbatohet varianti 1.1, ndërkohë që në klasat e arsimit të mesëm të ulët mund të ketë numër më të madh nxënësish dhe mund të zbatohet varianti 1.2.

Në shkollat e arsimit bazë duhet të kenë përparësi klasat 1-5. Sugjerohet që brenda mundësive, këto shkolla të përdorin mjedise, si: palestra, biblioteka, salla aktivitësh etj., që të mundësojnë zhvillimin e mësimin në një turn dhe me 45 minuta për klasat 1-5.

Gjithashtu, rekomandohet që klasat e ciklit fillor ta zhvillojnë mësimin paradite.

Shembull i organizimit të mësimin me dy turne

Shembull i organizimit të mësimin në një shkollë 9-vjeçare me numër të madh nxënësish (një turn)

- ✓ Klasa IX-A ka 33 nxënës.
- ✓ Klasa ndahet në dy grupe.
- ✓ Grupi i parë ka 17 nxënës.
- ✓ Grupi i dytë ka 16 nxënës.
- ✓ Klasa IX-A ka vetëm një regjistër, me të cilin punojnë të dyja grupet.
- ✓ Ndarja në dy grupe kryhet mundësisht duke ndjekur renditjen e nxënësve në regjistër: p.sh., grupi i parë nga numri 1-17, ndërsa grupi i dytë nga numri 18-33.
- ✓ Nxënësit nuk mund ta ndryshojnë grupin sa herë të duan. Ata do të caktohen në fillim në njërin prej grupeve dhe do ta vijojnë mësimin vetëm në atë grup.
- ✓ Orari i mësimin do të hartohet për grupin e parë të klasës IX-A, njësoj siç është hartuar edhe më parë nga shkolla. I njëjti orar do të zbatohet edhe për grupin e dytë.
- ✓ Grupi i parë do të zhvillojë mësim nga ora 8.00-11.15, ndërsa grupi i dytë nga ora 11.45-15.00.

Nxënësit e një grupi kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime për angazhimin, pjesëmarrjen dhe frekuencimin, si edhe në klasat e plota.

4.1.3 Skenari 1.3

Shkollat me dy turne dhe me numër të madh nxënësish, të cilat në mënyrën normale të funksionimit të tyre nuk plotësojnë protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për higjienën dhe për distancimin fizik.

1.3.1 Rastet, kur në mjediset fizike zhvillon mësim një shkollë. Këto shkolla:

- ndërtojnë një grafik për hyrjen dhe për daljen e nxënësve që të shmangët grumbullimi i tyre, pa prekur orën e fillimit dhe të mbarimit të shkollës;
- zhvillojnë mësimin me 4 nënturne, pra me dy nënturne brenda një turni.

Për turnin e parë

- ndajnë çdo klasë në dy grupe:
 - grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 8.00-10.45;
 - grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 11.00-13.45.

Për turnin e dytë

- ndajnë çdo klasë në dy grupe:
 - grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 14.00-16.45;
 - grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 17.00-19.45.

Rekomandohet që klasat e ciklit fillor ta zhvillojnë mësimin paradite.

Shembull i organizimit të mësimi në një shkollë 9-vjeçare me numër të madh nxënësish me dy turne (katër nënturne)

- Klasat 1-5 (AF) zhvillojnë mësim në dy nënturnet e turnit të parë.
- Secila klasë ndahet në dy grupe.
- Ndarja në dy grupe kryhet mundësisht duke ndjekur renditjen e nxënësve në regjistër: p.sh., grupi i parë nga numri 1-15, ndërsa grupi i dytë nga numri 16-30.
- Nxënësit nuk mund ta ndryshojnë grupin sa herë të duan. Ata do të regjistrohen në fillim në njërin prej grupeve dhe do ta vijojnë mësimin vetëm në atë grup.
- Nxënësit e një grupi kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime për angazhimin, pjesëmarrjen dhe frekuentimin, si edhe në klasat e plota.
- Një klasë ka vetëm një regjistër, me të cilin punojnë të dyja grupet.

Klasat	I-V
Grupi	1
Ora	8.00 – 10.45

Klasat	I-V
Grupi	2
Ora	11.00 – 13.45

- Klasat 6-9 (AMU) zhvillojnë mësim në dy nënturnet e turnit të dytë.
- Secila klasë ndahet në dy grupe.
- Ndarja në dy grupe kryhet mundësisht duke ndjekur renditjen e nxënësve në regjistër: psh. grupi i parë nga numri 1-15, ndërsa grupi i dytë nga numri 16-30.
- Nxënësit nuk mund ta ndryshojnë grupin sa herë të duan. Ata do të regjistrohen në fillim në njërin prej grupeve dhe do ta vijojnë mësimin vetëm në atë grup.
- Nxënësit e një grupi kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime për angazhimin, pjesëmarrjen dhe frekuentimin, si edhe në klasat e plota.

Klasat	VI-IX
Grupi	1
Ora	14.00 – 16.45

Klasat	VI-IX
Grupi	2
Ora	17.00 – 19.45

Shkolla në varësi të mjediseve që ka në dispozicion si klasa mësimore dhe në varësi të numrit të nxënësve për klasë (kur në disa klasa numri i nxënësve është i vogël dhe ruhet distancimi fizik) mund të organizojë mësimin edhe me tre turne. Kombinimet janë fleksibilitet i shkollës.

Shembull i organizimit të mësimit në një shkollë 9-vjeçare me numër të madh nxënësish me një turn të parë dhe dy nënturne të turnit të dytë

- Klasat 1-5 (AF) zhvillojnë mësim në turnin e parë nga ora 8.00 – 10.45
- Klasat 6-9 (AMU) zhvillojnë mësim në dy nënturne të turnit të dytë.
- Secila klasë ndahet në dy grupe.
- Ndarja në dy grupe kryhet mundësisht duke ndjekur renditjen e nxënësve në regjistrë: p.sh., grupi i parë nga numri 1-15, ndërsa grupi i dytë nga numri 16-30.
- Nxënësit nuk mund ta ndryshojnë grupin sa herë të duan. Ata do të regjistrohen në fillim në njërin prej grupeve dhe do ta vijojnë mësimin vetëm në atë grup.
- Nxënësit e një grupi kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime për angazhimin, pjesëmarrjen dhe frekuencimin, si edhe në klasat e plota.

Klasat	VI-IX
Grupi	1
Ora	11.00 – 13.45

Klasat	VI-IX
Grupi	2
Ora	14.00 – 16.45

1.3.2 Rastet, kur në një mjedis fizik zhvillojnë mësim dy shkolla. Këto shkolla:

- ndërtojnë një grafik për hyrjen dhe për daljen e nxënësve që të shmangët grumbullimi i tyre, pa prekur orën e fillimit dhe të mbarimit të shkollës.

Shkolla e parë zhvillon mësimin turnin e parë me dy nënturne.

- Ajo ndan çdo klasë në dy grupe:
 - grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 8.00-10.45;
 - grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 11.00-13.45.

Shkolla e dytë zhvillon mësimin turnin e dytë me dy nënturne.

- Ajo ndan çdo klasë në dy grupe:
 - grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 14.00-16.45.
 - grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 17.00-19.45.

Në variantin 1.3, ora e mësimit do të jetë 25 minuta. **Mësimi do të zhvillohet me dy orë të njëpasnjëshme.** Koha mësimore që i shtohet çdo mësuesi është afërsisht 2-3 orë mësimi në javë, të cilat mund të paguhet si orë suplementare.

Në skenarin e parë nuk ndryshon metodologjia e mësimit dhe vlerësimi i nxënësit, të cilat zhvillohen sipas udhëzimeve në fuqi. Për më shumë detaje, referojuni kapitullit të udhëzimeve metodike dhe kapitullit të vlerësimit të nxënësit.

4.2 SKENARI 2

Mësimi zhvillohet i kombinuar (një javë në shkollë dhe një javë në kushtet e shtëpisë), duke ruajtur të gjitha rregullat e higjienës dhe të distancimit fizik, në rast se do të ketë situatë të rënduar të pandemisë³.

4.2.1 Skenari 2.1

Shkollat me një turn dhe me numër të vogël nxënësish, të cilat plotësojnë protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për higjienën dhe për distancimin fizik, në varësi të numrit të nxënësve mund të zhvillojnë normalisht procesin mësimor ose të kombinohen klasat si p.sh.: në javën **tek zhvillojnë mësim në shkollë **klasat 1-3-5-7-9**, ndërkohë që **klasat 2-4-6-8** zhvillojnë mësimin online. Në javën **çift** këmbehen. Kombinimet i bën vetë shkolla duke u bazuar në kushtet specifike që ajo ka.**

4.2.2 Skenari 2.2

Shkollat me një turn dhe me numër të madh nxënësish, të cilat në mënyrën normale të funksionimit të tyre nuk plotësojnë protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për higjienën dhe për distancimin fizik. Në këtë rast këto shkolla:

- ndërtojnë një grafik për hyrjen dhe për daljen e nxënësve që të shmangët grumbullimi i tyre, pa prekur orën e fillimit dhe të mbarimit të shkollës;
- ndajnë çdo klasë në dy grupe:

Java tek

- grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 8.00-11.15 (në mjediset fizike të shkollës);
- grupi e dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 12.30-15.45 (online);

Java çift

- grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 8.00-11.15 (në mjediset fizike të shkollës);
- grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 12.30-15.45 (online).

Ora e mësimi do të jetë 30 minuta. **Mësimi do të zhvillohet me dy orë të njëpasnjëshme.** Koha mësimore që i shtohet çdo mësuesi është afërsisht 7 orë mësimi në javë, të cilat mund të paguhet si orë suplementare ose orët mësimore shtesë mund të realizohen me mësues shtesë.

³Situatën e pandemisë e përcakton Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale.

4.2.3 Skenari 2.3

Shkollat me dy turne dhe me numër të madh nxënësish, të cilat në mënyrën normale të funksionimit të tyre nuk plotësojnë protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për higjienën dhe për distancimin fizik:

2.3.1. Rastet, kur në mjediset fizike zhvillon mësim një shkollë. Këto shkolla:

- ndërtojnë një grafik për hyrjen dhe për daljen e nxënësve që të shmangët grumbullimi i tyre, pa prekur orën e fillimit dhe të mbarimit të shkollës;
- ndajnë çdo klasë në dy grupe;
- zhvillojnë mësimin me 4 nënturne.

Turni i parë:

Java tek

- grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 8.00-10.45 (mjedisi fizik në shkollë);
- grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 11.00-13.45 (online);

Java çift

- grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 8.00-10.45 (mjedisi fizik në shkollë);
- grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 11.00-13.45 (online).

Turni i dytë:

Java tek

- grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 14.00-16.45 (mjedisi fizik në shkollë);
- grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 17.00-19.45 (online). Në këtë rast mësimi online mund të zhvillohet edhe paradite;

Java çift

- grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 14.00-16.45 (mjedisi fizik në shkollë);
- grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 17.00-19.45 (online). Në këtë rast mësimi online mund të zhvillohet edhe paradite.

Në këtë rast nëse mësuesit që japin mësim në të dyja turnet, nuk janë të njëjtët atëherë oraret e nënturneve të dyta mund të afrohen.

2.3.2. Rastet, kur në mjediset fizike zhvillojnë mësim dy shkolla. Këto shkolla:

- ndërtojnë një grafik për hyrjen dhe për daljen e nxënësve që të shmanget grumbullimi i tyre, pa prekur orën e fillimit dhe të mbarimit të shkollës;
- ndajnë çdo klasë në dy grupe.

Shkolla e parë e zhvillon mësimin gjatë turnit të parë, me dy nënturne:

Java tek

- grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 8.00-10.45 (mjedisi fizik në shkollë);
- grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 11.00-13.45 (online);

Java çift

- grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 8.00-10.45 (mjedisi fizik në shkollë);
- grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 11.00-13.45 (online).

Shkolla e dytë e zhvillon mësimin gjatë turnit të dytë, me dy nënturne:

Java tek

- grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 14.00-16.45 (mjedisi fizik në shkollë);
- grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 17.00-19.45 (online). Në këtë rast mësimi online mund të zhvillohet edhe paradite;

Java çift

- grupi i dytë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 14.00-16.45 (mjedisi fizik në shkollë);
- grupi i parë i çdo klase do të zhvillojë mësim nga ora 17.00-19.45 (online). Në këtë rast mësimi online mund të zhvillohet edhe paradite.

Ora e mësimi do të jetë 25 minuta. ***Mësimi do të zhvillohet me dy orë të njëpasnjëshme.*** Koha mësimore që i shtohet çdo mësuesi është afërsisht 2-3 orë mësimi në javë, të cilat mund të paguhen si orë suplementare.

Në këtë skenar nuk ndryshon metodologjia e mësimi. Vlerësimi i nxënësit do të bëhet vetëm gjatë kohës që nxënësi është në klasë, sipas udhëzimeve që janë në fuqi. Për më shumë detaje, referojuni kapitullit të udhëzimeve metodike dhe kapitullit të vlerësimit të nxënësit.

4.3 SKENARI 3

Mësimi zhvillohet vetëm në distancë, online me platformë të dedikuar akademi.al, në rast se situata e COVID-19 përkeqësohet shumë në nivel kombëtar, në nivel lokal ose në nivel shkolle⁴.

Në këtë skenar shkolla do të hartojë orarin e shkollës për mësimin në distancë, online me platformë të dedikuar akademi.al. Për të lehtësuar punën e mësuesit, në komunikimin online, klasat me numër të madh nxënësish mund të ndahen me grupe ose mund të realizohet mësimi me të gjithë klasën nëse platforma online e krijon këtë mundësi.

Ora e mësimit do të jetë 25 minuta. **Mësimi zhvillohet me dy orë të njëpasnjëshme.** Për këtë skenar, udhëzimet për organizimin, udhëzimet metodologjike dhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësit i gjeni ***në kapitujt përkatës në këtë udhëzues.***

⁴Situatën e pandemisë e përcakton Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale

5 MASAT E SIGURISË DHE TË HIGJENËS

Në lidhje me masat e sigurisë dhe të higjienës në shkollë gjatë vitit shkollor 2020-2021, drejtuesit dhe mësuesit duhet t'i referohen udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, nr. 543/11 prot., datë 21.08.2020 "Mbi kujdesin dhe masat anti COVID-19 në strukturat arsimore parauniversitare për vitin shkollor 2020-2021". Ky udhëzim është dhënë i plotë në vijim.

Udhëzim "Mbi kujdesin dhe masat anti COVID-19 në strukturat arsimore parauniversitare për vitin shkollor 2020-2021"

5.1 Hyrje

Një nga dimensionet e rëndësishme për hapjen e suksesshme të shkollave mbetet mirëqenia dhe mbrojtja e fëmijëve nga infeksioni që sjell sëmundjen e COVID-19. Për këtë arsye, rekomandojmë si më poshtë:

5.2 Kujdesi për nxënësin

5.2.1 Hyrja dhe dalja nga ambientet e shkollës

- Orari për hyrjen e nxënësve në institucionet arsimore rregullohet sipas një grafiku, i cili hartohet nga drejtoria e institucionit arsimor dhe monitorohet nga mësuesit e kujdestarë.
- Nxënësit paraqiten në shkollë duke respektuar me përpikmëri orarin e komunikuar nga mësuesi kujdestar i tyre.
- Nxënësit hyjnë në shkollë, pasi janë vendosur në radhë një nga një, me largësi 2 metra.
- Nxënësi që ka simptoma të ngjashme apo temperaturë përpara ardhjes në shkollë, njofton mësuesin kujdestar, i cili në bashkëpunim me mjekun e shkollës ose mjekun e familjes, verifikon nëse nxënësi është i sëmurë apo jo.
- Justifikimi i mungesës bëhet vetëm nga mjeku i familjes.
- Personi përgjegjës i stafit të shkollës, i caktuar nga drejtori, duhet të kryejë vlerësimin për çdo nxënësi si më poshtë vijon:
 - ⇒ Matje të temperaturës me termometër digjital.
 - ⇒ Sprucim me alkool 60% ose dezinfektantë të tjerë në duar.
 - ⇒ Duhet të kontrollohen gjithë nxënësit që të jenë të pajisur me maskë me një përdorim ose me mbrojtëse të fytyrës prej tekstili (maskë), të cilat duhet të lahen në 60 gradë dhe të hekurosen, si me shami prej letre për higjienën e hundëve. Shkolla do të pajisë me maska nxënësit të cilët vijnë nga shtresa vulnerabël ose nxënësit me aftësi të kufizuara.
 - ⇒ Sipas mundësive mund të vendosen vasketa/tapet/sfungjer me solucion dezinfektues me bazë të klorit aktiv, për dezinfektimin e pjesëve të poshtme të këpucëve, përpara hyrjes në ambientet e brendshme të shkollës.

- Nuk lejohet që nxënësit të dalin nga godina dhe të rikthehen përsëri në të, brenda ditës.
- Dera e shkollës do të qëndrojë e mbyllur, ndërsa dritaret e klasave ku zhvillohet procesi mësimor, të qëndrojnë të hapura për të krijuar ajrosjen e nevojshme brenda tyre.
- Lejohet vetëm një hyrje dhe një dalje në ndërtesën e shkollës.
- Dalja nga ambientet e institucionit arsimor të bëhet sipas rregullave, duke ruajtur distancimin fizik (jo më pak se 1.5 metra) nën mbikëqyrjen e mësuesve kujdestarë dhe të punonjësve të tjerë të shkollës. Drejtimi i vendosjes së fëmijëve është vetëm në një kah apo në një drejtim, njëri pas tjetrit.
- Nxënësit që nuk zbatojnë këtë rregullore, të trajtohen me masë disiplinore nga komisioni i etikës dhe i sjelljes.
- Nxënësit me aftësi të kufizuara që nuk mund ta zbatojnë këtë rregullore, mund të lejohen që të dalin në hapësirat brenda shkollës ku të jenë caktuar kënde të veçanta në të cilat nxënësit të qetësohen dhe më pas të vazhdojnë përsëri mësimin normalisht, nën kujdesin e mësuesit ndihmës ose të ndonjë mësuesi tjetër në shkollë.

5.2.2 Qëndrimi dhe mësimi në klasa

- Gjatë procesit mësimor, mësuesi të qëndrojë në klasë duke respektuar distancimin fizik me nxënësit dhe me mësuesit e tjerë, në 2 metra.
- Brenda klasës, nxënësit qëndrojnë ulur nga një nxënës në bankë dhe bankat janë të paktë 1.5 metra larg njëra-tjetrës. Në klasat ku kjo nuk është e mundur, nxënësit do të ndahen në klasa të tjera.
- Nëse transporti i nxënësve kryhet me mjetet e transportit të dedikuara ose publik, duhet të mbahet maska gjatë gjithë kohës së transportit (vajtje-ardhje) dhe këto mjete duhet t'i nënshtrohen me rigorozitet udhëzuesit për transportin.
- Nxënësve të arsimit fillor u rekomandohet të mbajnë maskë gjatë orëve të mësimi.
- Nxënësit e arsimit fillor duhet të mbajnë maskë gjatë aktiviteteve jashtë orëve të mësimi në ambientet e shkollës.
- Nxënësit e arsimit të mesëm të ulët (AMU) dhe arsimit të mesëm të lartë (AML) duhet të mbajnë maskë në ambientet e brendshme dhe në të gjitha aktivitetet mësimore në ambientet e shkollës.
- Mësuesit të sigurohen që në klasë të gjithë të jenë të pajisur me maskë dhe t'i mbajnë rregullisht ato.
- Nxënësit ndalohen të dalin nga klasa gjatë orëve të mësimi, përveç rasteve kur duhet të përdorin tualetet. Në këtë rast nxënësi duhet të shoqërohet.
- Kur është e mundur, të praktikohet mësimi në ambient të hapur (oborr shkolle), duke respektuar largësinë dhe rregullat e mësipërme.
- Nuk lejohet ushqimi në klasë.

5.2.3 Lëvizjet në mjediset e brendshme të shkollës

- Lëvizja e nxënësve në klasa, laboratorë, palestra dhe nëpër korridore duhet të jetë e përcaktuar në mënyrë që çdo zonë të ketë numrin më të vogël të individëve që lëvizin në të. Kjo do të thotë që p.sh., nxënësit e klasës I^a do të hyjnë vetëm në klasën e përcaktuar për nxënësit e kësaj klase, do të përdorin vetëm tualetin në korridorin ku ndodhet klasa e tyre,

pa u takuar asnjë moment me nxënës të klasave të tjera.

- Rregullat për lëvizjen e nxënësve të jenë të afishuara në ambientet e klasave dhe në korridore.
- Nuk lejohen qëndrimet në korridore.
- Nxënësit ruajnë distancimin fizik, kur lëvizin në korridore.
- Komunikimi, në rast nevojë, i nxënësit me drejtuesit apo stafin mësimor do të kryhet nëpërmjet mësuesit përgjegjës të katit, duke respektuar distancimin fizik dhe rregullat e tjera të përcaktuara më lart. Komunikimi mund të jetë edhe nëpërmjet telefonit apo kompjuterit, kur nxënësi nuk ndodhet në klasë.
- Nuk do të përdoren sende personale të panevojshme për procesin mësimor.
- Nuk do të kontaktohen personat që mund të jenë të pranishëm në mjediset e institucionit arsimor.

5.2.4 Kujdesi për higjienën

- Nxënësit të ndërgjegjësohen dhe të mbahen në komunikim të vazhdueshëm për rëndësinë që ka distancimi fizik dhe higjiena personale në ambientet brenda dhe jashtë shkollës, nëpërmjet mesazheve sensibilizuese të shpërndara nga ekipi mjekësor dhe shërbimi psiko-social i shkollës.
- Nxënësve duhet t'u flitet në mënyrë të vazhdueshme për rregullat e higjienës, larjen e duarve, mënyrën e kollitjes dhe të teshtitjes, si dhe mbajtjen e maskave.
- Çdo nxënës në shkollë të lajë duart pas çdo veprimi që mund të përbëjë rrezik për përhapjen e virusit, si p.sh.: prekja e hundës, syve, gojës etj.
- Të minimizohet prekja e herëpashershme e maskës dhe të kihet kujdes që heqja të kryhet nga pjesa e pasme e maskës dhe të lahen menjëherë duart apo të përdoren dezinfektantë në fund të këtij procesi.
- Duhet të sigurohen nga struktura arsimore: uji i pijshëm, sapuni i lëngshëm, letra për fshirjen e duarve dhe xheli me përmbajtje alkooli 60% në të gjitha ambientet e shkollës.
- Gjatë qëndrimit në ambientet e shkollës, çdo individ duhet të mbajë detyrimsht maskë (sipas specifikimit të grup-moshave).
- Dritaret duhet të mbahen të hapura ose të paktën të ajrosen 5-6 herë gjatë kohës së mësimi.
- Klasat duhet të kenë aq nxënës sa lejojnë distancimin jo më pak se 1.5 metra nga njëri nxënës tek tjetri. Janë të ndaluara takimet dhe mbledhjet ballë për ballë në ambientet e institucionit arsimor.
- Nëse nxënësi manifeston gjendje stresi dhe ankthi, ai i drejtohet shërbimit psiko-social të shkollës nëpërmjet mësuesit kujdestar dhe "Këndit të psikologut" online pranë DRAP-it.
- Në një klasë apo laborator të mos qëndrojnë më shumë nxënës sesa mund të qëndrojnë në atë mjedis, duke respektuar distancimin fizik.
- Aktivitetet sportive dhe artistike në ambientet e shkollës duhet të kryhen jo më shumë se 10 persona dhe duke ruajtur distancimin fizik.
- Të jenë të afishuara në të gjitha ambientet e shkollës, postera mbi masat e parandalimit të infeksionit COVID-19, me mesazhe të qarta dhe të thjeshta.
- Të vendosen postera të veçantë për mënyrën e larjes së duarve dhe të mbajtjes së maskës.

- Në hyrje dhe në dalje të ambienteve të shkollës, rekomandohet të vendoset një higjienizues për duart në trajtë solucioni me përmbajtje aktive të alkoolit 60%, i cili duhet të jetë gjatë gjithë kohës i pranishëm.
- Të kryhet dezinfektimi i çdo klase, çdo ditë. Pas përfundimit të procesit mësimor të kryhet pastrimi i sipërfaqeve dhe i orëdivë me lëndë dezinfektuese.
- Dezinfektimi i mjediseve të brendshme dhe të jashtme të shkollës duhet të kryhet pas procesit mësimor, 2 herë në javë.
- Do të pranohen në ambientet e shkollës vetëm nxënësit apo prindërit (në rastet e nxënësve të ciklit fillor) që do të firmosin rregulloren mbi parandalimin e përhapjes së COVID-19.
- Përpara se të rifillojnë mësimin në ambientet e shkollës, sipas rregulloreve të reja për parandalimin e përhapjes së COVID-19, nxënësit duhet të plotësojnë formularin e vetëdeklarimit për situatën e tyre shëndetësore dhe të familjarëve të tyre, e cila shërben për të hetuar paraprakisht mundësinë e një vatre infeksioni COVID-19.
- Nxënësit që nuk zbatojnë rregulloren, trajtohen me masë sipas rregullores së shkollës.

5.3 Kujdesi për mësuesin

- Mësuesi paraqitet në shkollë në orën e përcaktuar nga drejtoria, përpara ardhjes së nxënësve.
- Mësuesit kujdestarë dhe mësuesit dezhurn paraqiten në shkollë në orën e përcaktuar nga drejtoria e shkollës.
- Mësuesi mban gjatë kohës së qëndrimit në shkollë maskën dhe solucione dezinfektuese.
- Staf i mjekësor i shkollës (mjekja/infermierja e shkollës) ose personeli i shkollës, i caktuar nga drejtuesi dhe i trajnuar për veprimet e mëposhtme, kryen për çdo nxënës procedurën si më poshtë:
 - ⇒ Mat temperaturën me termometër digjital.
 - ⇒ Spërkat me solucion dezinfektues me përmbajtje 60% alkooli, duart e nxënësve dhe të stafit.
 - ⇒ Kontrollon nëse çdo nxënës është i pajisur me maskë.
- Gjatë orës së mësimi, mësuesi qëndron në klasë duke respektuar distancimin fizik me nxënësit.
- Mësuesi i arsimit fillor largohet nga shkolla, kur klasat e tij mbarojnë procesin mësimor.
- Mësuesi i AMU-së dhe i AML-së largohet nga shkolla vetëm me miratim të drejtorit të shkollës.

5.4 Kujdesi për personelin ndihmës

5.4.1 Sanitaret

- Personeli ndihmës paraqitet në shkollë në orën e përcaktuar nga drejtoria e shkollës.
- Sanitaret të mbajnë gjatë gjithë orarit të punës, maskën dhe solucione dezinfektuese.
- Korridoret pastrohen çdo dy orë.

- Tualetet pastrohen e dezinfektohen çdo 30 minuta.
- Rezervuarëve të ujit që mund të ketë shkolla, t'u hidhet klor sipas udhëzimeve përkatëse çdo ditë.
- Dorezat e dyerve dhe të dritareve të çdo klase dhe mjedisi pune, si dhe parmakët e shkallëve dhe vende të tjera, të pastrohen dhe të dezinfektohen sa më shpesh.
- Largimi nga institucioni arsimor të bëhet pas përfundimit të pastrimit dhe të dezinfektimit të çdo mjedisi të tij.
- Të kryhen të gjitha detyrat duke respektuar distancimin fizik me nxënësit dhe me mësuesit.

5.4.2 Roja i institucionit/oficeri i sigurisë

- Paraqitja në shkollë bëhet në orën e përcaktuar nga drejtoria e shkollës.
- Roja/oficeri i sigurisë të mbajë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat dhe solucione dezinfektuese.
- Roja nuk duhet të lejojë prezencën e prindërve dhe të çdo individi tjetër, brenda në institucion (me përjashtim të nxënësve dhe të personelit të deklaruar të institucionit arsimor).
- Çdo kërkesë për komunikim me drejtuesin e institucionit të bëhet nëpërmjet numrit të kontaktit të drejtorit ose të stafit drejtues.
- Të kryhen të gjitha detyrat duke respektuar distancimin fizik me nxënësit, mësuesit dhe sanitaret.

5.5 Kujdesi për prindin

- Të nënshkruajë ose të konfirmojë në rrugë elektronike, tek mësuesi apo mësuesi kujdestar, rregulloren për masat ndaj COVID-19.
- Plotëson me përgjegjësi formularin e vetëdeklarimit ditor për gjendjen shëndetësore të fëmijës në numrin e kontaktit të mësuesit kujdestar.
- Në rast nevojë për komunikim me mësuesin apo drejtuesin, përdor komunikimin elektronik dhe në rastet e planifikuara takimet ballë për ballë.
- Në rastet e shoqërimit të fëmijës/ fëmijëve në institucionin arsimor, nuk futet brenda mjedisit të shkollës për çfarëdo lloj arsyeje që mund të paraqesë. Për nxënësit me aftësi të kufizuara vendos komisioni i shkollës nëse prindi ose ndihmësi personal i nxënësit do të qëndrojë me të gjatë gjithë qëndrimit të tij në klasë.

5.6 Kujdesi për drejtuesit

- Ngrënë grupe pune dhe hartojnë planet e veprimit për menaxhimin e situatës, garantimin e standardeve dhe respektimin e rregullave të përcaktuara më këtë udhëzim.
- Monitorojnë pajisjen e nxënësve dhe të stafit me mjetet mbrojtëse, si: maskë, xhel dezinfektues për përdorim personal (sipas mundësive).
- Mbajnë kontakte, përmes komunikimit elektronik, me njësinë e vetëqeverisjes vendore, njësinë e mbrojtjes së fëmijëve, strukturat e shëndetit publik, Policinë e Shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese për ecurinë e procesit mësimor.
- Për çdo nxënës që paraqet probleme shëndetësore, si p.sh rritje të temperaturës etj., apo ka

njoftim nga prindi se ka pasur kontakt me dikë të prekur me COVID-19, si dhe nëse prindi përkatës është i sëmurë apo ka pasur kontakte me COVID-19, lajmërojnë menjëherë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe strukturën përkatëse në këto njësi.

- Për çdo mësues apo personel tjetër të shkollës, i cili paraqet probleme shëndetësore, si p.sh., rritje të temperaturës etj., apo ka njoftim se ka pasur kontakt me dikë të prekur me COVID-19, lajmërojnë menjëherë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe strukturën përkatëse në këto njësi.
- Ndjekin me rigorizitet protokollin e kontrollit të riskut, të miratuar nga autoritetet shëndetësore.

Rezervojmë të drejtën të rivlerësojmë elementet e këtij udhëzimi në rast të ndryshimeve epidemiologjike të COVID-19.

PJESA E DYTË

TABELA E PËRMBAJTJES

-UDHËZIME ORGANIZATIVE PËR DRAP-ET, ZVA-TË DHE SHKOLLAT

Udhëzime për DRAP/ZVA-të

Udhëzime për shkollat

Udhëzime specifike për punonjësit e shërbimit psiko-social

Udhëzime specifike për oficerët e sigurisë në shkollë

-UDHËZIME METODOLOGJIKE

Udhëzime të përgjithshme metodologjike

Udhëzime metodologjike për secilin skenar

-UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësve në skenarin 1

Vlerësimi i nxënësve në skenarin 2

Vlerësimi i nxënësve në skenarin 3

-NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

-VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR, PROVIMET KOMBËTARE PËR ARSIMIN BAZË DHE MATURA SHTETËRORE

-MBËSHTETJA DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE, DREJTUESVE DHE PJESËS TJETËR TË STAFI ARSIMOR

-MBËSHTETJA DHE KOMUNIKIMI ME PRINDËRIT

6 UDHËZIME ORGANIZATIVE PËR DRAP-ET, ZVA-TË DHE SHKOLLAT

6.1 Udhëzime për DRAP/ZVA-të

Bazuar në vendimet dhe në udhëzimet e MASR- së, DRAP/ZVA-të në bashkëpunim të ngushtë me njësitë e vetëqeverisjes vendore, strukturat shëndetësore, strukturat e policisë etj., ndjekin me përparësi:

- ⇒ marrjen e masave për sigurimin e kushteve në çdo institucion arsimor për zhvillimin e mësimi me standardet e kërkuara;
- ⇒ sigurimin e mësimi në çdo shkollë sipas skenarëve të parashikuar;
- ⇒ monitorimin e mësimi në shkollat që ka në varësi;
- ⇒ raportimin në DRAP, në DPAP dhe në MASR për zhvillimin e mësimi;
- ⇒ mbështetjen për drejtorët e shkollave në zgjidhjen e problematikave që mund të lindin gjatë procesit mësimor;
- ⇒ sigurimin e punonjësve të shërbimit psiko-social;
- ⇒ zbatimin e kurrikulës së arsimit parashkollor të bazuar në kornizën kurrikulare të arsimit parashkollor, në standardet e zhvillimit dhe të të nxënit për fëmijët 3-6 vjeç, programet e arsimit parashkollor për çdo grup dhe në kornizën e vlerësimit, duke i sjellë ato në kontekstin e situates;
- ⇒ zbatimin e kurrikulës me kompetenca në klasat I-XII, bazuar në udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës në arsimin fillor (Material ndihmës për mësuesit dhe drejtuesit në arsimin fillor), në udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët (Material ndihmës për mësuesit dhe drejtuesit në arsimin e mesëm të ulët IZHA-sot ASCAP, janar, 2017 (<https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2017/04/Udhezues-per-AMU-2017.pdf>)); në udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës në gjimnaz (Material ndihmës për mësuesit dhe drejtuesit në gjimnaz, IZHA-sot ASCAP, tetor 2016 (<https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/Udhezues-per-gjimnazin.pdf>), në udhëzuesit kurrikularë lëndorë në arsimin e mesëm të ulët (Material ndihmës për mësuesit në arsimin e mesëm të ulët sipas profileve përkatëse, IZHA-sot ASCAP, 2018; <https://www.ascap.edu.al/udhezues-lendore/>); në udhëzuesit kurrikularë lëndorë në arsimin e mesëm të lartë (Material ndihmës për mësuesit në arsimin e mesëm të lartë sipas profileve përkatëse, IZHA-sot ASCAP, 2018, <https://ascap.edu.al/udhezues-lendore/>); si dhe në materialin shpjegues për vlerësimin e nxënësit në arsimin e mesëm të ulët, ASCAP, shtator 2019;
- ⇒ përfshirjen e kurrikulës digjitale dhe përdorimin e infrastrukturës digjitale në shkollat e mesme dhe angazhimin e inkurajimin e mësuesve në përfshirjen e kurrikulave digjitale, për garantimin e zhvillimit të kompetencës digjitale tek nxënësit;
- ⇒ zbatimin e Portofolit Evropian të Gjuhëve (PEGJ) për vlerësimin e nxënësve, si dhe për planifikimin e orëve mësimore, për modelet shqiptare të akredituara nga Këshilli i Evropës nr. 96.2008 për arsimin e mesëm dhe nr. 106.2010 për arsimin bazë dhe modelet e regjistruara: nr.2014 RO20, nr.2014 RO22 dhe nr.2014 RO23 për gjuhën italiane;
- ⇒ mësimin e gjuhëve të huaja:

a. Në arsimin fillor

Mësimi i gjuhës së huaj të parë fillon në klasën III dhe ZVA-të në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave të respektojnë parimin e shumëgjuhësisë sipas angazhimeve dypalëshe dhe nevojave të përcaktuara nga vetë shkollat. Planifikimi të realizohet duke pasur parasysh stafin mësimdhënës dhe strukturën e shkollës. Nuk planifikohet gjuhë e huaj e dytë për klasat III, IV dhe V të arsimit fillor.

b. Për nxënësit që nuk kanë zhvilluar gjuhë të huaja

DRAP-et dhe ZVA-të me drejtoritë e shkollave të sigurojnë zhvillimin e gjuhës së huaj në të dyja ciklet, si dhe për nxënësit e klasës IX të sigurohet mësimi i gjuhës së huaj, në mënyrë që nxënësit të jenë të përgatitur për provimin e gjuhës së huaj në provimet kombëtare të arsimit bazë.

c. Për sigurimin e vijimësisë së gjuhës së huaj

DRAP-et dhe ZVAP-të me drejtoritë e shkollave të sigurojnë vijimësinë e gjuhës së huaj të parë, të nisur në klasën III të arsimit fillor, si dhe të gjuhës së huaj të dytë, të nisur në klasën VI, pavarësisht planit mësimor me të cilin punohet. Edhe në rastet e transferimeve, të ruhet vijimësia e gjuhës së huaj të parë dhe të dytë nga arsimi bazë në arsimin e mesëm të lartë dhe atë profesional.

d. Për zbatimin e memorandumeve dhe të marrëveshjeve dypalëshe

Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të vijojnë zbatimin e marrëveshjeve dhe memorandumeve si vijon:

- për gjuhën italiane, vijon zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për programin “Iliria”. Planifikimi i shkollave që do të zhvillojnë gjuhën italiane, është kompetencë dhe përgjegjësi e ZVAP-eve;
- për gjuhën frënge, vijon zbatimi i angazhimeve në kuadër të aderimit në Organizatën Botërore të Frankofonisë, duke mundësuar që 30% e nxënësve që mësojnë gjuhë të huaj, të mësojnë gjuhën frënge si gjuhë të huaj të parë nga klasa III e arsimit fillor dhe gjuhë të huaj të dytë nga klasa VI e arsimit të mesëm të ulët deri në klasën XII të arsimit të mesëm të lartë;
- ZVAP Elbasan, Durrës, Korçë, Shkodër dhe Tiranë, në shkollat e të cilave funksionojnë klasat mbështetëse për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane, shqiptaro-franceze dhe shqiptaro-gjermane të sigurojnë hapjen e klasave në shkollat e përcaktuara në memorandume, duke filluar në klasën III të arsimit fillor dhe në klasën VI të arsimit të mesëm të ulët për fazën tranzitore.
- ngritjen dhe funksionimin e rrjeteve profesionale të mësuesve sipas profileve përkatëse për zbatimin e kurrikulës së re, të mësuesve të klasave kolektive dhe të mësuesve ndihmës;
- konsolidimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”;
- zbatimin e planeve mësimore të miratuara nga MASR dhe të publikuara në faqen zyrtare të ASCAP-it.

6.2 Udhëzime për shkollat

6.2.1 Duke u bazuar në vendimet dhe në udhëzimet e MASR- së, në varësi të variantit që do të zbatohet, secila shkollë:

- ⇒ do të përcaktojë mjediset e zhvillimit të mësimin dhe numrin e mjediseve fizike të klasave që ka në dispozicion për të realizuar mësimin;
- ⇒ do të përgatisë mjediset e zhvillimit të mësimin duke siguruar kushtet për shëndetin dhe për sigurinë e nxënësve;
- ⇒ do të hartojë planimetrinë e shkollës për orientimin e nxënësve, lidhur me lëvizjet e nxënësve brenda shkollës dhe me numrin e nxënësve që do të zhvillojnë mësim në secilin seksion, kat etj.;
- ⇒ do të përdorë si klasa mësimore të gjitha mjediset e shkollës, përfshirë edhe palestrën, bibliotekën, sallat e aktiviteteve etj.;
- ⇒ do të përcaktojë numrin e nxënësve për secilën klasë;
- ⇒ do të ndajë në grupe klasat nëse numri i nxënësve është më i madh se numri i përcaktuar për një mjedis fizik klase;
- ⇒ do të përcaktojë mësuesit që do të japin mësim në secilën klasë;
- ⇒ do të përcaktojë ngarkesën mësimore për secilin mësues duke llogaritur edhe orët suplementare (nëse ka të tilla);
- ⇒ do të përcaktojë grafikun e hyrjes dhe të daljes nga shkolla të nxënësve, sipas variantit që po zbaton shkolla (me turne ose jo);
- ⇒ do të përcaktojë orarin e fillimit dhe të mbarimit të mësimin në rast se ka dy turne ose tre - katër nënturne;
- ⇒ do të bëjë kujdes që të mos vendosë të njëjtët nxënës të zhvillojnë mësim në orët e turnit të dytë, duke i alternuar ata;
- ⇒ do të hartojë orarin mësimor. **Rekomandohet që gjatë vitit shkollor 2020 – 2021 në shkollat që do të ketë dy - katër turne dhe orët do të jenë 30 minuta ose 25 minuta, mësimi të organizohet me dy orë të njëpasnjëshme për të lehtësuar procesin e të nxënësve, përdorimin e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimin e nxënësve;**
- ⇒ do të grupojë në orarin e një dite mësimi (sa të jetë e mundur) lëndët: Edukim fizik, sporte dhe shëndet; Muzikë; Art pamor; Teatër; Kërcim, module kurrikulare etj., të cilat mund të zhvillohen në mjediset jashtë shkollës ose përreth saj. Në lëndët: Edukim fizik, sporte dhe shëndet; Teatër; Kërcim; Muzikë etj., mësuesit duhet të bëjnë kujdes për zhvillimin e atyre lloj veprimtarish mësimore, të cilat shmangin kontaktin e afërt të nxënësve me njëri-tjetrin.
- ⇒ do të përcaktojë grupet që do të zhvillojnë mësimin në javën çift ose në javën tek (në rast se mësimi zhvillohet i kombinuar me mësimin online);
- ⇒ do të krijojë mundësi që orë dhe tema të veçanta mësimore në lëndë të ndryshme të zhvillohen në mjediset jashtë shkollës ose përreth saj, si p.sh.: në lëndën e gjuhës shqipe mund të zhvillohen në oborrin e shkollës ose jashtë saj, konkurse, biseda letrare, projekte kurrikulare etj.; në lëndën e matematikës mund të zhvillohen në oborrin e shkollës ose jashtë saj, konkurse, orë mësimore për njësitë e matjes, orë mësimore që lidhen me gjetjen e syprinës së figurave, orë mësimore që kanë të bëjnë me llogaritjen e distancave, orë të statistikës, orë të projektit kurrikular etj.; në lëndën e gjeografisë mund të zhvillohen orë të veçanta në oborrin e shkollës ose jashtë saj, për vëzhgime (si p.sh., për motin, orientimin në natyrë, temperaturën e ajrit, erën, lagështirën, dherat etj.), sikurse dhe orë projektesh e veprimtarish praktike;

- ⇒ do të përdorë edhe praktikantët gjatë procesit mësimor sipas kushteve specifike;
- ⇒ do të krijojë kushtet për zhvillimin e aftësive sociale- emocionale, për shëndetin mendor dhe për arritjet e nxënësve;
- ⇒ do të sigurojë mirëfunksionin e shërbimit psiko-social në mbështetje të nxënësve, mësuesve dhe prindërve;
- ⇒ do të bashkëpunojë me autoritetet lokale dhe shëndetësore për t'u pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme për të ruajtur të sigurt stafin dhe nxënësit;
- ⇒ do të bashkëpunojë me DRAP-et dhe ZVA-të për të siguruar pajisje digjitale dhe internet;
- ⇒ do të bashkëpunojë me ASCAP-in për të trajnuar stafin e saj.
- ⇒ do të hartojë plane për zbatimin e të tre skenarëve të parashikuar;
- ⇒ do të hartojë plan për kthimin e procesit mësimor në mësim të kombinuar (në mjedisin fizik të shkollës dhe në distancë);
- ⇒ do të hartojë plan që do të jetë i gatshëm vetëm për mësimin në distancë;
- ⇒ **do të caktojë koordinatorin/koordinatorët (nëndrejtor) përgjegjës** për koordinimin brenda shkollës, të zbatimit të planeve dhe veçanërisht për mësimin në distancë gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID- 19. **Koordinatori përgjegjës siguron dhe mban kontakte me strukturat shëndetësore.**
- ⇒ **do të caktojë një person përgjegjës që mund të jetë mësues i TIK-ut**, kur ka të tillë në shkollë, i cili mbështet mësuesit në përdorimin e platformave online apo të formave të tjera të mësimin në distancë, në mënyrë që mësuesit të jenë të gatshëm në rast se duhet të zbatohen skenarët e mësimin në distancë;
- ⇒ **do të hartojë rregullore** për detyrat e mësuesit kujdestar, rregullore për detyrat e mësuesit dezurn, rregullore për nxënësit dhe rregullore për prindërit lidhur me funksionimin e masave për mbarëvajtjen e procesit mësimor gjatë vitit shkollor 2020 -2021;
- ⇒ do të krijojë një komision brenda shkollës për të monitoruar masat e ndërmarra dhe për të luftuar përhapjen e COVID-19 në shkollë.

6.2.2 Udhëzime specifike për shkollat, lidhur me realizimin me sukses të mësimin në distancë (online) në rast të zbatimit të skenarëve që e përmbajnë këtë formë mësimi.

Lëvizja drejt mësimin në distancë është një sfidë për shkollën dhe mësuesit, por ajo duhet parë edhe si një mundësi për zhvillimin e veprimtarive autentike të të nxënësit.

Mësuesi, gjatë mësimin në distancë (mësimin online):

- ⇒ duhet të shmangë përvojat e të mësuarit ballë për ballë në mjedisin fizik të klasës, të cilat nuk mund të zbatohen gjatë mësimin në distancë;
- ⇒ duhet të zbatojë praktika gjithëpërfshirëse që të gjithë fëmijët të kenë qasje në të nxënë dhe të jenë të angazhuar në mënyrë aktive në mësimin online;
- ⇒ duhet të flasë me nxënësit, prindërit apo kujdestarët e tyre në lidhje me sigurinë kibernetike gjatë përdorimit nga nxënësit të teknologjive të ndryshme të komunikimit;
- ⇒ duhet të angazhojë nxënësit si bashkëprojektues të platformave online dhe të formave të shpërndarjes së informacionit;

- ⇒ duhet të planifikojë seanca të rregullta dhe të shkurtra të mësimi online, ku mund të japë shpjegime të qarta rreth përmbajtjes mësimore dhe udhëzime specifike për realizimin e detyrave, duke i konkretizuar me shembuj të qartë;
- ⇒ duhet të mbajë parasysh që koha që nxënësit shpenzojnë përpara ekranit duhet të jetë më e shkurtër se ajo e mësimi në klasë;
- ⇒ duhet të sigurojë që planifikimi i programit mësimor të jetë i arritshëm dhe komunikimi të jetë i thjeshtë dhe i qartë për të gjithë nxënësit;
- ⇒ duhet të modelojë një qasje të qartë dhe të kujdesshme ndaj nxënësve dhe konteksteve individuale të familjeve të tyre, duke mbështetur mirëqenien sociale dhe emocionale të nxënësve;
- ⇒ duhet të integrojë një gamë teknologjish dhe të planifikojë aktivitete që integrojnë ndërveprime online dhe me lëvizjen fizike, si p.sh.: këngë, recitime, vizatime digjitale dhe lojëra të përshtatshme për nxënësit;
- ⇒ duhet të përcaktojë format e komunikimit me prindërit (kontakte me telefon, grupe në whats-app, forume diskutimesh online, email etj.);
- ⇒ duhet të planifikojë një mësimdhënie të pavarur. Prindërit mund të jenë në punë, mund të punojnë nga shtëpia ose mund të mos kenë mundësi për të ndihmuar fëmijët. Është e rëndësishme që shkolla dhe mësuesi të planifikojnë përmbajtje që nuk kërkojnë shumë mbështetje nga prindërit, të cilët tashmë mund të jenë të lodhur nga mësimi në distancë dhe gjithë situata aktuale;
- ⇒ duhet të vendosë orare ditore të përcaktuara se kur do të takohet online me nxënësit. Një ditë e plotë para një ekrani është shumë për fëmijët dhe prindërit, veçanërisht për familjet që mund të ndajnë një pajisje ose që nuk e kanë një të tillë;
- ⇒ duhet të japë udhëzime të qarta lidhur me pjesëmarrjen e nxënësve gjatë zhvillimit të mësimi në distancë (online);
- ⇒ duhet të sigurojë reflektime të shpeshta përmes vlerësimit të vazhdueshëm online të njohurive si dhe të japë komente mbi punën e nxënësve, me qëllim që t'i mbajë ata të motivuar për të ecur përpara;
- ⇒ duhet të përzgjedhë mjetet e duhura (një shumëllojshmëri e gjerë platformash teknologjike të lira ose pa pagesë janë në dispozicion për të mbështetur qasjen online) dhe duhet të kufizojë numrin e mjeteve, të aplikacioneve dhe të platformave të vështira për t'u përdorur nga të gjithë nxënësit, si dhe të atyre me pagesë;
- ⇒ duhet të mbajë parasysh që është më e vështirë për nxënësit të ndjekin detyrat gjatë mësimi në distancë (online), pasi ai nuk gjendet në të njëjtin mjedis fizik me ta. P.sh., për të ndihmuar fëmijët e vegjël që të përqendrohen, përdoren shkronja me ngjyra të ndryshme në ekran për të dalluar idetë dhe konceptet e rëndësishme;
- ⇒ duhet të japë udhëzime të formuluar thjesht, qartë dhe shkurt (mund të japë udhëzime nëpërmjet regjistrimit në video në vend të leximit të tekstit);
- ⇒ duhet të ofrojë mundësi për aktivitete fizike dhe lojëra. Një model cilësor i mësimi në distancë u siguron nxënësve qasje në ushtrime dhe aktivitete të bazuara në lojëra që mbështesin shëndetin e tyre mendor dhe fizik. Shkollat duhet të sugjerojnë aktivitete nëpërmjet të cilave nxënësit angazhohen në mënyrë të pavarur, si: ushtrime fizike, kërcime, lojëra të ndryshme, vizatime, recitime, teatër, debate, eksperimente në lëndët e shkencave të natyrës, kërkime, projekte etj.;
- ⇒ duhet të sigurojë zhvillimin e mësimi online në një mjedis të qetë në shtëpi;
- ⇒ duhet të vishet ashtu si në shkollë dhe të kërkojë që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë;

- ⇒ duhet të përcaktojë dhe të vendosë së bashku me nxënësit, rregullat e klasës online dhe etikën e sjelljes online;
- ⇒ duhet të vëzhgojë nxënësit gjatë mësimin në distancë nëse kanë nevojë për mbështetjen e psikologut. Vëzhgimi i gjendjes së tyre emocionale, i ndjenjës së ankthit dhe të frikës është më i rëndësishëm sesa vëzhgimi i njohurive. Në rastet kur mësuesi vëren që nxënësi shfaq ndjenja të ankthit, frikës, emocioneve, brenda parimeve të etikës dhe të protokollit të përcaktuar, referon rastin për mbështetje psiko-sociale pranë shërbimit psiko-social shkollor dhe në komunikim të vazhdueshëm dhe transparent me prindin/ kujdestarin ligjor të nxënësit.

6.3 Udhëzime specifike për punonjësit e shërbimit psiko-social

Punonjësit e shërbimit psiko-social, duke u bazuar në vendimet dhe në udhëzimet e MASR- së dhe të DPAP-së, realizojnë strategjitë / aktivitetet / detyrat e mëposhtme.

Koha	Fushat e shërbimeve psikologjike shkollore gjithëpërfshirëse	Strategjitë / aktivitetet / detyrat
Para fillimit të procesit mësimor	Konsultimi dhe bashkëpunimi	⇒ Asiston në hartimin e protokolleve të masave ndaj COVID-19 dhe të procedurave të zbatimit së bashku me stafin e shkollës, duke vlerësuar nevojat sociale, emocionale dhe mësimore të nxënësve. ⇒ Bashkëpunon me mësuesit, mësuesit ndihmës, stafin mjekësor, oficerin e sigurisë, qeverinë e nxënësve për të ofruar mbështetje profesionale për nxënësit dhe për stafin në lidhje me ndryshimet në rregulloren e shkollës, sjelljen në komunitet dhe respektimin e protokolleve të masave ndaj COVID-19; ⇒ Informon dhe diskuton për pasojat psikologjike dhe emocionale që sjellin këto ndryshime.
	Mbledhja dhe hartimi i një databaze me të dhëna	⇒ Harton pyetësorë për të marrë një informacion më të detajuar në lidhje me nevojat e nxënësve gjatë fillimit të shkollës. ⇒ Ndihmon në hartimin, zbatimin dhe interpretimin e një plani për fillimin e shkollës, duke vlerësuar nevojat sociale, emocionale dhe mësimore të nxënësve. ⇒ Bashkëpunon me familjen, institucionet e tjera për ofrimin dhe sigurimin e mbështetjes psiko-sociale.
	Bashkëpunimi me familjen, shkollën dhe komunitetin	⇒ Krijon ura bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel vendor dhe me ofrues shërbimesh, si p.sh., organizata, me qëllim që të identifikojë shërbime të

		disponueshme mbështetëse për nxënësit për të përmbushur nevojat e tyre. ⇒ Bashkëpunon me familjet për të dhënë një informacion paraprak orientues se si të përgatisin fëmijët për fillimin e shkollës.
Zhvillimi i procesit mësimor	Ndërhyrjet dhe mbështetjet mësimore	⇒ Ofron konsultime për të ndihmuar mësuesit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e procesit mësimor.
	Shërbime dhe ndërhyrje të shëndetit mendor dhe të sjelljes	⇒ Ofron shërbime profesionale dhe ndërhyrje në menaxhimin e sjelljeve. ⇒ Bashkëpunon me pjesëtarë të tjerë të stafit për të zhvilluar orë edukative dhe mësimin e teknikave (strategjive) përballuese (<i>Si të menaxhojmë emocionet, stresin dhe ankthin?</i>). ⇒ Informon mësuesit rreth simptomave të depresionit, ankthit, stresit, mungesës së motivimit për të lehtësuar procesin e identifikimit të nxënësve që kanë nevojë për mbështetje. ⇒ Vëzhgon në mënyrë të vazhdueshme klasat për të monitoruar sjelljen e nxënësve nëse shfaqin shenja të stresit apo të ankthit. ⇒ Konsultohet me stafin dhe qeverinë e nxënësve për të diskutuar mundësitë e rimbylljes së shkollës dhe përgatitjen emocionale nëse ndodh një gjë e tillë. ⇒ Ofron mbështetje për mësuesit që shfaqin nivele të larta të stresit dhe të ankthit. ⇒ Identifikon dhe ofron mbështetje për nxënësit që kanë humbur një anëtar të afërt si pasojë e COVID-19. ⇒ Vlerëson rrezikun për nxënësit që paraqesin rrezik për veten ose të tjerët. ⇒ Referon nxënësit në shërbime të tjera të jashtme për të marrë ndihmë profesionale shtesë dhe më të detajuar, bazuar tek nevojat e tyre. ⇒ Informon nxënësit në lidhje me temat si ankthi, humbja, frika, duke marrë parasysh dhe moshën e tyre.
	Bashkëpunimi me familjen, shkollën dhe komunitetin	⇒ Ofron seanca trajnimi për prindërit me tema të tilla si mbështetja e shëndetit mendor të nxënësve, zakonet e mira të studimit në shtëpi, menaxhimi i stresit për familjet dhe lidhjet e komunitetit që mbështesin nevojat e familjes. ⇒ Takohet me prindërit për të diskutuar nevojat e nxënësve dhe u ofron prindërve informacione se si të

		vazhdojnë të mbështesin fëmijët e tyre gjatë procesit mësimor. ⇒ Kontakton në mënyre virtuale/online me prindërit për të ofruar mbështetje dhe ndihmë në plotësimin e nevojave që mund të kenë nxënësit. ⇒ Kontakton në mënyrë virtuale/online për të orientuar prindërit se si të mbështesin dhe të menaxhojnë sjelljen e fëmijës gjatë kësaj situate.
	Praktika të barabarta për të gjithë nxënësit	⇒ Ofron burime në lidhje me tema të diversitetit. ⇒ Inkurajon, ofron lehtësimin ose bashkëlehtësimin, ose udhëheq takime të niveleve të ndryshme, klasave të ndryshme ose të temave të ndryshme për të adresuar praktikatat e drejta dhe diversitetin.
	Praktika të hulumtimit dhe të bazuara në prova	⇒ Rishikon programet dhe përkrahjet aktuale mësimore dhe të sjelljes. ⇒ Mban shënim anët e forta dhe nevojat për përmirësim të stafit mësimor dhe të klimës së përgjithshme në institucionin arsimor.
	Praktika ligjore, etike dhe profesionale	⇒ Takohet me nxënësit për të përfunduar vlerësimet individuale, kur koha është e përshtatshme për nxënësit. Nëse është e mundur, konsideron që t'ju të ofrojë më tepër kohë për t'u përshtatur me mjedisin shkollor dhe me rutinën. ⇒ Punon me stafin drejtues për të përzgjedhur informacionin e nevojshëm për të ndarë me nxënësit dhe për zgjidhjet e mundshme që do të bëhen për ata. ⇒ Vendos kontakte me nxënësit e prekur emocionalisht për të vlerësuar nivelin e tyre të funksionimit. ⇒ Takohet me prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara, për të diskutuar nevojat e nxënësve dhe për të siguruar lejen për vlerësime. ⇒ Këshillohet me ekipet multidisiplinare për të përshtatur planet e edukimit individual për të përmbushur nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara ose të grupimeve të tjera në nevojë (fëmijë nga komuniteti rom, nga komuniteti egjiptian, fëmijë nga familje me vështirësi ekonomike-sociale etj.). ⇒ Koordinon punën me shërbimin psiko-social në nivel ZVA-je për fëmijët me aftësi të kufizuara duke punuar ngushtësisht me mësuesin ndihmës, mësuesin lëndor, prindin në vendosjen e rezultateve zhvillimore dhe të të nxënësve për fëmijët me aftësi të kufizuara.

6.4 Udhëzime specifike për oficerët e sigurisë në shkollë

Oficeri i sigurisë:

- ⇒ është person mbështetës për respektimin e rregullave të sigurisë gjatë vitit shkollor 2020-2021;
- ⇒ mbështet drejtuesit, mësuesit, nxënësit dhe prindërit për të kryer çdo ditë vetëvlerësimin dhe vlerësimin e pranisë së simptomave të COVID-19;
- ⇒ mbështet drejtuesit, mësuesit, nxënësit dhe prindërit për të bërë të mundur zbatimin e masave të distancimit fizik dhe të higjienës;
- ⇒ ndihmon stafin drejtues për krijimin e një plani sigurie për organizimin e nxënësve në klasa, duke respektuar masat e distancimit fizik dhe të higjienës;
- ⇒ orienton dhe koordinon nxënësit nëpër klasa duke respektuar masat e distancimit fizik dhe të higjienës;
- ⇒ mban një databazë të nxënësve dhe të stafit të shkollës që shfaqin simptoma, shqetësime, probleme shëndetësore, si dhe bashkëpunon me strukturat shëndetësore përgjegjëse në rastet e dyshuara ose kur evidentohen nxënës me simptoma të COVID-19;
- ⇒ evidenton dhe raporton te drejtori i shkollës, raste të moszbatimit të masave të distancimit fizik dhe të higjienës nga nxënësit dhe nga stafi i shkollës;
- ⇒ udhëzon dhe mbikëqyr respektimin e distancimit fizik dhe të rregullave të higjienës nga nxënësit, gjatë hyrje-daljes nga shkolla;
- ⇒ kontribuon në bashkëpunim me stafin e shkollës për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për respektimin e masave të distancimit fizik dhe të higjienës, si dhe të sigurisë online gjatë përdorimit të platformave online, internetit;
- ⇒ ndërgjegjëson, edukon dhe përforcon sjelljet e përshtatshme gjatë frekuentimit të shkollës me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19;
- ⇒ shkëmben informacion me oficerin e policimit në komunitet, për rastet e konfirmuara me COVID-19 (stafi i shkollës, nxënësit dhe familjarët e tyre), duke ruajtur konfidencialitetin e këtyre rasteve.

7 UDHËZIME METODOLOGJIKE

7.1 Udhëzime të përgjithshme metodologjike

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies/nxënies janë faktorë të rëndësishëm për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Pavarësisht se secila lëndë e kurrikulës përdor metoda, strategji dhe teknika të veçanta për arritjen e rezultateve të të nxënit, procesi i mësimdhënies/nxënies nga pikëpamja metodologjike ka disa parime të përbashkëta mbi të cilat bazohet kurrikula e arsimit parauniversitar dhe që mësuesit duhet t'i marrin parasysh në punën e tyre. Këto parime janë:

- *Zhvillimi i kompetencave kyç për të nxënit gjatë gjithë jetës.* Të zotërosh njohuri dhe aftësi do të thotë të jesh në gjendje t'i përdorësh ato gjatë gjithë jetës. Sprova më e madhe në lidhje me zhvillimin e kompetencave është zbatimi nga nxënësi i njohurive dhe i aftësive të përftuara në situata të pahasura më parë prej tij.
- *Mësimdhënia ka parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësve ndaj mësuesi e planifikon të nxënit mbi bazën e tyre.* Të nxësh do të thotë të pasurosh përvojën tënde me një përvojë të re.
- *Mësimdhënia planifikohet duke u bazuar në rezultatet e pritshme të të nxënit.*
- *Mësimdhënia e integruar lidh përmbajtjet e veçanta të lëndëve mësimore me qëllim zbatimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave në situata konkrete nga jeta e përditshme.* Mësimdhënia e integruar përafron më mirë dijet njerëzore, të cilat kurrikula e zbatuar merr përsipër t'i zhvillojë.
- *Mësimdhënia duhet të krijojë një klimë bashkëpunimi me qëllim nxitjen e interesit dhe motivimin e nxënësve.*
- *Mësimdhënia zhvillohet mbi bazën e burimeve të shumëllojshme të informacionit.* Mësuesi duhet të përdorë burime të ndryshme të nxënit (këtu përfshihen dhe burimet online) për të nxitur pjesëmarrjen aktive të nxënësve në çdo veprimtari mësimore.
- *TIK-u mbështet dhe lehtëson të nxënit e nxënësve.* Të nxënit nëpërmjet TIK-ut luan rol të rëndësishëm në mësimdhënie. Shkollat duhet të eksplorojnë jo vetëm mundësitë e përdorimit të TIK-ut për të mbështetur mësimdhënien, por edhe hapësirat e tij për të krijuar mënyra të reja e të ndryshme të nxënit.
- *Mësimdhënia duhet të ketë në qendër nxënësin.* Kjo nënkupton që mësuesi duhet të përshtatë metodat e mësimdhënies me nevojat, interesat dhe veçoritë individuale të nxënësve, me qëllim që të sigurohet suksesi i secilit prej tyre. Stilet e të nxënit ndryshojnë nga njëri nxënës te tjetri, për këtë qëllim mësuesi përzgjedh metodat, teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies me synim përfshirjen aktive të secilit nxënës në orën e mësimit.

Kurrikula e arsimit parauniversitar u jep mësuesve liri profesionale përmes së cilës mund të kërkojnë dhe zbatojnë shumëllojshmëri metodash dhe teknikash. *Metodat, strategjitë, teknikat e mësimdhënies përfshijnë:* punën në grup, lojën me role, grupet e ekspertëve, zhvillimin e aftësive në praktikë, kërkimin dhe hulumtimin, diskutimin, shpjegimet, prezantimet, përdorimin e teknologjisë etj.

Përdorimi i metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse duhet konsideruar si një proces didaktik që pasurohet gjithnjë me elemente të rinj dhe zbatohet në mënyrë krijuese. Kjo gjë u vu re dhe gjatë mësimit në distancë në Shqipëri, gjatë periudhës mars- qershor 2020, ku mësuesit në të gjithë vendin u përballën me sfidën e përdorimit të teknologjisë dhe mjeteve të komunikimit online.

Dy format kryesore të komunikimit që u përdorën në vendin tonë gjatë asaj periudhe ishin:

- Mësime të xhiruara dhe të transmetuara në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH), si dhe videot te kanali *Youtube* i MASR-së apo edhe te platforma *akademi.al*.
- Komunikimi mes nxënësve dhe mësuesve përmes rrjeteve sociale, email, chat apo përmes platformave të ndryshme që mundësoi krijimin e klasave virtuale (google classroom, google hangout, edmodo, zoom etj.).

Të gjitha metodat dhe format e sipërpërmendura të komunikimit sugjerohen të përdoren nga shkollat në të tre skenarët e parashikuar për vitin shkollor 2020-2021.

Mësuesi gjatë planifikimit të metodave dhe strategjive të mësimit duhet të harrojë që nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive, krahasime të rezultateve apo nxjerrje të konkluzioneve. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre kudo ato janë, si në mjedisin fizik në klasë ashtu dhe përgjatë mësimit në distancë.

Thuhet shpesh që teknologjia e ndihmon nxënësin të zhvillojë të gjitha llojet e aftësive, nga ato më të thjeshtat deri te ato më të ndërlikuarat. Për mësuesin, sa e rëndësishme është të dijë se për çfarë do ta përdorë teknologjinë, po aq e rëndësishme është të dijë dhe mënyrën se si nxënia mund të përmirësohet përmes teknologjisë.

Aktivitetet pamore me programet kompjuterike mund të jenë komponentë thelbësorë për të ndihmuar nxënësin të shohë se si konceptet zbatohen në situata reale. Një shembull i përdorimit të teknologjisë në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” janë simulimet nëpërmjet lojërave kompjuterike ku nxënësit luajnë rolin e vendimmarrësit në situata historike në mënyrë që të shikojnë rëndësinë e këtyre ngjarjeve në jetën e tyre të përditshme dhe të zhvillojnë më mirë aftësitë e të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemit. Format e tjera të përdorimit të teknologjisë janë dhe udhëtimet virtuale në kohë, kuizet online etj. Nxënësit mësojnë rreth kulturave të ndryshme duke parë fotografi, filma, video, prezantime në power-point dhe tekste të përzgjedhura. Nxënësit, gjatë udhëtimit virtual, u përgjigjen pyetjeve të mësuesit.

Në lëndën e matematikës mund të krijohen video ndërvepruese ku zgjidhja e situatave problemore mund të jetë me faza. Pra mësuesi mbasi paraqet situatën problemore, kërkon nga nxënësi të japë përgjigje hap pas hapi për të gjetur zgjidhjen e situatës problemore.

Gjatë orëve të ndryshme të mësimit, si në klasë dhe në distancë, metodat ndërthuren me njëra-tjetrën aq sa është e vështirë të dallosh kufijtë midis tyre, por mësuesi ka gjithnjë në vëmendje që:

- metodat e mësimit duhet të adresohen nxënësve dhe plotësojnë nevojat e tyre;

- veprimtaritë e të nxënësve duhet të synojnë zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik dhe krijues të të gjithë nxënësve;
- përdorimi i një larmie metodash mësimore përbën një domosdoshmëri, pasi nxënës të ndryshëm mësojnë në mënyra të ndryshme.

Mësuesi duhet të jetë i kujdesshëm në përzgjedhjen e metodave dhe të strategjive që nxisin punën me nxënësit, sidomos me nxënësit me nevojë të veçanta, kur përfshihen:

 **Nxënësit me vështirësi në të nxënë.** Shumë nxënës me vështirësi në të nxënë arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënësve si nxënës të tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies. Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencave, mësuesi përzgjedh teknikat dhe metodat më të përshtatshme që u japin mundësi këtyre nxënësve të përmbushin rezultatet e të nxënësve.

 **Nxënësit e talentuar.** Mësuesit duhet të krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse nxënësve u krijohen mundësi të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe më të zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifike të kompetencave kyç dhe të lëndës, të fokusohen në çështjet kroskurrikulare, si dhe të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënësve brenda dhe jashtë shkollës.

Në të gjithë skenarët, gjatë orës së mësimi, mësuesi do të përqendrohet më së shumti në dhënien dhe në përvetësimin e njohurive të reja duke shtuar më shumë punën individuale të nxënësve në shtëpi, për të plotësuar të tërë procesin e të nxënësve.

7.2 Udhëzime metodologjike për secilin skenar

Në kushtet aktuale të vitit të ri shkollor, mësuesit dhe nxënësit janë të lirë të përzgjedhin përmbajtjen, metodat, format dhe kushtet për të arritur rezultatet e të nxënësve.

Realizimi i mësimdhënies në kushtet aktuale kërkon bashkëpunim mes mësuesve për planifikimin e përmbajtjes, metodave dhe mjeteve mësimore, me qëllim shkëmbimin e përvojave pozitive mes tyre. Po ashtu mësuesi duhet të krijojë një komunikim dhe bashkëpunim të rregullt dhe të vazhdueshëm me prindërit, për të mundësuar një ndarje të qartë të përgjegjësisë për arritjen e rezultateve të të nxënësve. Mësuesi është aktori kryesor i suksesit të mësimdhënies në çfarëdo formë që zhvillohet ajo. Më poshtë janë përcaktuar disa udhëzime metodologjike për zhvillimin e mësimi sipas secilit skenar.

SKENARI 1

Mësimi zhvillohet në mjediset fizike të shkollës, duke ruajtur të gjitha rregullat e higjienës dhe të distancimit fizik, nëse situata e pandemisë është e qëndrueshme.

- 📖 Mësuesit duhet të kenë parasysh të gjitha udhëzimet e përgjithshme të sipërpërmendura, lidhur me metodat, teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies.
- 📖 Mësuesit duhet të bashkëpunojnë së bashku për të shqyrtuar udhëzuesit kurrikularë sipas lëndëve dhe cikleve, të përgatitura nga ASCAP. Secili mësues para se të hartojë planifikimin ditor dhe të përcaktojë metodat për realizimin e rezultateve të të nxënësve, duhet të identifikojë:
 - ✓ ato njohuri që nxënësit mësojnë gjatë periudhës së mësimi në distancë këtë pranverë;
 - ✓ ato njohuri që nuk patën mundësi të zhvillohen.
- 📖 Mësuesit duhet të identifikojnë boshllëqet e nxënësve të tyre për të përcaktuar metoda dhe strategji, të cilat plotësojnë nevojat individuale të tyre.
- 📖 Mësuesit duhet të shqyrtojnë dhe të përcaktojnë strategjitë më të efektshme të mësimdhënies.
- 📖 Mësuesit duhet të krijojnë plane individuale për të ndihmuar nxënësit me vështirësi në të nxënë për plotësimin e boshllëqeve nga viti shkollor i mëparshëm.
- 📖 Mësuesit duhet t'u paraqesin nxënësve të tyre rezultatet e të nxënësve që do të përmbushen gjatë vitit shkollor 2020-2021.
- 📖 Mësuesit duhet të trajtojnë veten dhe nxënësit e tyre në lidhje me aplikacionet dhe mjetet e teknologjisë dhe të komunikimit që mund të përdorin, në rast se mësimi do të zhvillohet në distancë, për shkak të një mbylljeje të papritur.
- 📖 Mësuesit, bashkë me nxënësit, duhet të vendosin se çfarë platforme dhe çfarë mjetesh komunikimi mund të përdorin gjatë mësimi në distancë.
- 📖 Mësuesit duhet t'u japin nxënësve udhëzime të qarta dhe specifike për kohën dhe për mënyrën e përdorimit të platformës së përzgjedhur së bashku, duke nxitur nxënësit që ta përdorin atë në shtëpitë e tyre.

SKENARI 2

Mësimi zhvillohet i kombinuar (një javë në shkollë dhe një javë në kushtet e shtëpisë), duke zbatuar të gjitha rregullat e higjienës dhe të distancimit fizik, në rast se do të ketë situatë të rënduar të pandemisë.

- 📖 Mësuesit duhet të kenë parasysh udhëzimet e përgjithshme, si dhe udhëzimet e dhëna për skenarin 1 dhe për skenarin 3, në lidhje me metodat dhe strategjitë e mësimdhënies.
- 📖 Drejtuesit e shkollave dhe mësuesit duhet t'u japin përparësi për të mësuar në mjediset e shkollës, nxënësve të arsimit fillor, si dhe nxënësve të klasave të 9-ta dhe 12-ta, duke pasur parasysh që:
 - ✓ humbjet e nxënësve në arsimin fillor mund të jenë më të mëdha;
 - ✓ nxënësit e klasave të 9-ta dhe të 12-ta kanë nevojë për mbështetje të menjëhershme në përgatitjen për provimet kombëtare;

- ✓ të gjithë këto grupe nxënësish mund të përfitojnë më shumë se të tjerët nga koha në klasë me mësuesin.

- 📖 Mësuesit duhet t'u japin prioritet atyre aftësive që mund/duhet të mësohen në mjedisin fizik të klasës në krahasim me mësimin në distancë.
- 📖 Mësuesit duhet të përcaktojnë oraret më të favorshme për nxënësit me nevoja të veçanta.
- 📖 Mësuesit, në rastet kur e lejon infrastruktura në shkollë, mund të krijojnë lidhje direkte të orës së mësimi në klasë për t'u ndjekur në kohë reale nga nxënësit që janë në shtëpi. Kjo nënkupton që mësimi të ndiqet online në kohë reale në klasë nga ai grup nxënësish i përcaktuar për zhvillimin e mësimi online sipas javës tek apo javës çift.

SKENARI 3

Mësimi zhvillohet vetëm në distancë, online me platformë të dedikuar akademi.al, në rast se situata e COVID- 19 përkeqësohet shumë në nivel kombëtar, në nivel lokal ose në nivel shkolle

- 📖 Mësuesit dhe nxënësit duhet të angazhohen çdo ditë në procesin mësimor.
- 📖 Drejtuesit dhe mësuesit duhet t'u referohen udhëzimeve të mëparshme të publikuara nga MASR dhe nga ASCAP, për mësimdhënien në distancë.
- 📖 Mësuesit në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave përcaktojnë platformën dhe mjetet e komunikimit me nxënësit.
- 📖 Drejtuesit duhet të përcaktojnë orarin mësimor për çdo klasë.
- 📖 Mësuesit duhet të planifikojnë përmbajtjen mësimore, metodat dhe strategjitë e mësimdhënies, si dhe strategjitë për monitorimin dhe për vlerësimin e nxënësve (*shikoni udhëzuesit gjatë mësimi në distancë*). Për këtë ata kanë parasysh:

- ✓ rezultatet e të nxënësve që synojnë të arrijnë;
- ✓ përmbajtjen e mësimi;
- ✓ mënyrën dhe kohën e caktuar për komunikim;
- ✓ mjetet dhe burimet në dispozicion.

- 📖 Mësuesit duhet të bashkëpunojnë brenda ekipit lëndor ose rrjeteve profesionale. P.sh., në një shkollë të madhe, brenda një ekipi lëndor, një mësues mund të jetë përgjegjës për planifikimin e kurrikulës dhe për regjistrimin e mësimëve në distancë. Rolet mund të caktohen duke u bazuar në pikat e forta të mësuesve.
- 📖 Mësuesit në bashkëpunim me komisionin në bazë shkolle dhe me mbështetjen aktive të shërbimit psiko-social duhet të zhvillojnë plane edukative individuale për të gjithë nxënësit me aftësi të kufizuara.
- 📖 Mësuesit duhet të mbajnë komunikim të vazhdueshëm me prindërit.


Për të mbështetur nxënësit gjatë mësimi të tyre në distancë, mësuesit:

- ✍ mund të planifikojnë dhe të komunikojnë përmbajtjen e mësimi në distancë për të gjithë javën. *Planifikimi dhe organizimi i mësimëve, detyrave dhe takimeve përgjatë një javë në vend të një dite, do t'u lejojë nxënësve dhe familjeve të planifikojnë më mirë kohën e tyre mësimore brenda rutinave dhe nevojave të tyre të përditshme;*

- ✍ mund të sugjerojnë mënyra me të cilat nxënësit mund të organizojnë kohën e tyre, përfshirë një plan pune për ndarjen e punës së tyre gjatë ditëve të javës;
- ✍ duhet të përcaktojnë data për realizimin e detyrave nga nxënësit dhe të ofrojnë një mundësi të dytë për ata të cilët nuk e kanë përfunduar detyrën (sigurohuni dhe monitoroni që ata të përfundojnë detyrën dhe pranoi të japin një arsye përse nuk e kanë përfunduar në kohë detyrën);
- ✍ duhet të dërgojnë reflektimet për të gjitha detyrat e realizuara duke i shoqëruar me zgjidhjen e tyre, brenda një jave shkollore (*pasi nxënësit i kanë dërguar këto detyra te mësuesi sipas afatit të përcaktuar*);
- ✍ duhet të drejtojnë platformat, mjetet në internet, hyrjet dhe fjalëkalimet e përdorura për lëndën dhe nxënësit e tyre;
- ✍ duhet të komunikojnë me prindërit për të adresuar çdo çështje që nxënësit mund të kenë në lidhje me prezencën e tyre gjatë mësimin në distancë, realizimin e detyrave, komunikimin me shokët, aspektet e shëndetit mendor, menaxhimit të stresit, ankthit, emocioneve dhe aspektet e menaxhimit të sjelljes së tyre online etj.;
- ✍ duhet të identifikojnë nxënësit që nuk janë duke u angazhuar rregullisht dhe të kërkojnë informacion shtesë për të zbuluar pse këta nxënës nuk janë angazhuar (*p.sh., boshllëqet e krijuara, sfidat në komunikim, nevojat emocionale dhe sociale etj.*);
- ✍ duhet të përcaktojnë hapat e ardhshëm për të mbështetur potencialisht secilin nga nxënësit e mësipërm.

8 UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE

Qëllimi kryesor i vlerësimit të nxënësve është përmirësimi i përmbushjes së rezultateve të të nxënësve nga nxënësi dhe i vetë procesit të të nxënësve. Gjatë vitit shkollor 2020-2021, *vlerësimi i nxënësve si pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve duhet të përqendrohet në nxitjen dhe në mbështetjen e fëmijëve për të nxënë. Parimet e vlerësimit të përcaktuara në Kornizën e vlerësimit të nxënësve në arsimin parauniversitar⁵, si vlefshmëria, transparenca, besueshmëria, duhet të udhëheqin praktikën vlerësuese të mësuesve në klasë, duke vendosur fort theksin në mirëqenien e nxënësve dhe gjithëpërfshirjen e tyre. Format e vlerësimit të nxënësve: vlerësimi i vazhduar, vlerësimi i portofolit dhe vlerësimi i testit/detyrës përmblendhëse, duhet t'i shërbejnë përmbushjes së këtij qëllimi dhe të reflektojnë zbatimin e parimeve.*



Metodat dhe teknikat e vlerësimit duhet të jenë të larmishme në mënyrë që mësuesit të mund të realizojnë një vlerësim të besueshëm dhe të vlefshëm, bazuar në reflektime dhe sugjerime që mbështesin dhe nxitin progresin e nxënësve. Metodat dhe teknikat e përzgjedhura duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to, duke i dhënë mundësi të gjithë nxënësve të demonstrojnë arritjet e tyre.

Vlerësimi si proces që drejton të nxënësve, udhëhiqet nga rezultatet e të nxënësve të përcaktuara në programet lëndore. Mësuesi duhet të sigurohet që vlerësimi është i përshtatshëm me rezultatet e synuara, duke konsideruar me kujdes faktorët kryesorë të vlerësimit.

Në varësi të specifikave që do të ketë zhvillimi i procesit mësimor-edukativ në secilin skenar, në pjesën në vazhdim të këtij dokumenti janë dhënë orientime dhe sugjerime që duhet të mbahen parasysh nga mësuesit dhe nga drejtuesit e institucioneve arsimore në lidhje me vlerësimin e nxënësve.

⁵<https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Korniza-e-vleresimit-te-nxenesit-23-korrik-2015.pdf>

VLERËSIMI I NXËNËSVE NË SKENARIN 1

Mësimi zhvillohet në mjediset fizike të shkollës, duke ruajtur të gjitha rregullat e higjienës dhe të distancimit fizik, nëse situata e pandemisë është e qëndrueshme.

Vlerësimi i nxënësit kryhet referuar të gjitha udhëzimeve dhe dokumenteve të tjera mbështetëse për vlerësimin, të cilat janë dhënë më poshtë.

- 📄 Për klasat 1-9, udhëzimi i MASR-së, nr. 34, datë 11.09.2018, “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”.
- 📄 Për klasat 10-12, udhëzimi i MASR-së, nr. 14, datë 28.07.2016, “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin e mesëm të lartë”.
- 📄 Materiali shpjegues në ndihmë të shkollave “Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë⁶”.
- 📄 Nivelet e arritjeve të nxënësve për vlerësimin e kompetencave në shkallët kurrikulare 1-2, 3-4, 5-6.
- 📄 Udhëzuesit kurrikularë lëndorë për AMU-në dhe për AML-në (rubrika e vlerësimit të nxënësve).

Në rastin e këtij skenari, pavarësisht se mësimi zhvillohet fizikisht në klasë, për shkak të kompleksitetit të situatës dhe të ndikimit të saj në mirëqenien fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve, mësuesit duhet të tregojnë kujdes të veçantë për vlerësimin e nxënësve dhe të mbajnë në vëmendje orientimet e mëposhtme.

- 📁 Në dy javët e para të vitit shkollor 2020-2021, procesi i mësimdhënie-nxënies duhet përqendruar më së shumti në përsëritjen e njohurive dhe të aftësive të mësuara gjatë mësimin në distancë në vitin shkollor 2019-2020. Në këtë periudhë nuk ka vlerësime të mirëfillta të nxënësve, por vetëm reflektime për të nxitur dhe për të motivuar nxënësit në përsëritjen e tyre.
- 📁 Në vijim të procesit të mësimdhënie – nxënies, komentet dhe sugjerimet e mësuesve gjatë vlerësimit duhet të përqendrohen në nxitjen dhe në mbështetjen e nxënësve për të nxënë. Nëse mësuesit janë mbështetës, të durueshëm, inkurajues, pozitivë dhe të vëmendshëm ndaj nxënësve, atëherë do të shmangen efektet negative psikologjike që mund të shkaktojë pandemia tek ata.
- 📁 Vlerësimi i nxënësve duhet të nxjerrë në pah arritjet e tyre, në mënyrë që ata të inkurajohen të mësojnë me më shumë dëshirë. Ai duhet të konsiderohet si një mjet në ndihmë të nxënësve që ata të njohin më mirë aftësitë e tyre në të nxënë, të zhvillojnë e të përdorin talentet dhe aftësitë në mënyrë sa më të dobishme.
- 📁 Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta duhet të bëhet në mënyrë të tillë që t’u japë atyre mundësinë të demonstrojnë çfarë dinë dhe mund të bëjnë në përmbushje të rezultateve të të nxënës dhe rezultateve zhvillimore që janë vendosur në planin edukativ individual (PEI). Për këtë qëllim mësuesi duhet të përshtatë detyrat/veprimtaritë vlerësuese me mundësitë dhe me nevojat që këta nxënës kanë.

⁶<https://www.ascap.edu.al/vleresimi-i-nxenesit-ne-amu-dhe-aml/>

- ☞ Metodatat dhe teknikat e përzgjedhura duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.
- ☞ Vlerësimi i nxënësve duhet të mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësve të programeve mësimore. Mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato rezultate që nuk janë në program.
- ☞ Metodatat, teknikat dhe strategjitë e vlerësimit të vazhduar duhet të jenë të shumëllojshme dhe të përfshijnë pyetjet dhe përgjigjet e nxënësve, pjesëmarrjen në diskutime, vlerësimin e detyrave të shtëpisë, vlerësimin e problemeve që shtrojnë zgjidhje të situatave të jetës së përditshme, vetëvlerësimin e nxënësit etj., për t'u dhënë mundësi të gjithë nxënësve të shprehin sa më mirë arritjet e tyre.
- ☞ Mësuesit duhet të bëjnë kujdes për shmangien e mbingarkesës me detyra dhe teste të tepërta.
- ☞ Mësuesit e lëndëve të fushave: *“Shoqëria dhe mjedisi”, “Arte”, “Teknologji dhe TIK”, “Edukim fizik, sporte dhe shëndet” etj., NUK zhvillojnë teste, por detyra përmbledhëse me shkrim ose me gojë, në mënyrë që nxënësit të mos ngarkohen me teste për të gjitha lëndët.*
- ☞ Kujdes! Testi/detyra përmbledhëse nuk duhet të jetë e mbingarkuar dhe të synojë vlerësimin e të gjitha çështjeve që nxënësi ka zhvilluar. Nuk duhet të harrojmë që ky lloj vlerësimi është një ndër format e vlerësimit. Për monitorimin e progresit dhe për matjen e arritjeve të nxënësve, mësuesi përdor dhe format e tjera të vlerësimit.
- ☞ Mësuesit duhet të bëjnë kujdes për të shmangur mbingarkimin e nxënësve me detyra të tepërta të portofolit të nxënësit për një periudhë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE NË SKENARIN 2

Mësimi zhvillohet i kombinuar (një javë në shkollë dhe një javë në kushtet e shtëpisë), duke ruajtur të gjitha rregullat e higjienës dhe të distancimit fizik, në rast se do të ketë situatë të rënduar të pandemisë.

Vlerësimi i nxënësit kryhet referuar të gjitha udhëzimeve dhe dokumenteve të tjera mbështetëse për vlerësimin, të cilat janë dhënë më poshtë.

- 📄 Për klasat 1-9, udhëzimi i MASR-së, nr. 34, datë 11.09.2018, “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”.
- 📄 Për klasat 10-12, udhëzimi i MASR-së, nr. 14, datë 28.07.2016, “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin e mesëm të lartë”.
- 📄 Materiali shpjegues në ndihmë të shkollave “Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë”⁷.
- 📄 Nivelet e arritjeve të nxënësve për vlerësimin e kompetencave në shkallët kurrikulare 1-2, 3-4, 5-6.
- 📄 Udhëzuesit kurrikularë lëndorë për AMU-në dhe për AML-në (rubrika e vlerësimit të nxënësve).

Për shkak të kompleksitetit të situatës dhe të ndikimit të saj në mirëqenien fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve, mësuesit duhet të tregojnë kujdes të veçantë për vlerësimin e nxënësve dhe të mbajnë në vëmendje orientimet e mëposhtme.

📁 **Në këtë skenar vlerësimi i nxënësit do të bëhet vetëm gjatë kohës që nxënësi zhvillon mësimin në klasë, sipas udhëzimeve që janë në fuqi.**

📁 Në dy javët e para të vitit shkollor 2020-2021, procesi i mësimdhënie-nxënies duhet përqendruar më së shumti në përsëritjen e njohurive dhe të aftësive të mësuara gjatë mësimin në distancë në vitin shkollor 2019-2020. Në këtë periudhë nuk ka vlerësime të mirëfillta të nxënësve, por vetëm reflektime për të nxitur dhe motivuar nxënësit në përsëritjen e tyre.

📁 Komentet dhe sugjerimet e mësuesve gjatë vlerësimit duhet të përqendrohen në nxitjen dhe në mbështetjen e fëmijëve për të nxënë. Nëse mësuesit janë mbështetës, të durueshëm, inkurajues, pozitivë dhe të vëmendshëm ndaj nxënësve, atëherë do të shmangen efektet negative psikologjike që mund të shkaktojnë pandemia tek ata.

📁 Vlerësimi i nxënësve duhet të nxjerrë në pah arritjet e tyre, në mënyrë që ata të inkurajohen të mësojnë me më shumë dëshirë. Ai duhet të konsiderohet si një mjet në ndihmë të nxënësve, që ata të njohin më mirë aftësitë e tyre në të nxënë, të zhvillojnë e të përdorin talentet dhe aftësitë në mënyrë sa më të dobishme.

📁 Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta duhet të bëhet në mënyrë të tillë që t’u japë atyre mundësinë të demonstrojnë çfarë dinë dhe mund të bëjnë në përbushje të rezultateve të të nxënës dhe rezultateve zhvillimore që janë vendosur në planin edukativ

⁷<https://www.ascap.edu.al/vleresimi-i-nxenesit-ne-amu-dhe-aml/>

individual (PEI). Për këtë qëllim mësuesi duhet të përshtatë detyrat/veprimtaritë vlerësuese me mundësitë dhe me nevojat që këta nxënës kanë.

- ☞ Metodatat dhe teknikat e përzgjedhura duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.
- ☞ Vlerësimi i nxënësve duhet të mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësve të programeve mësimore. Mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato rezultate që nuk janë në program.
- ☞ Metodatat, teknikat dhe strategjitë e vlerësimit të vazhduar duhet të jenë të shumëllojshme dhe të përfshijnë pyetjet dhe përgjigjet e nxënësve, pjesëmarrjen në diskutime, vlerësimin e detyrave të shtëpisë, vlerësimin e problemeve që shtrijnë zgjidhje të situatave të jetës së përditshme, vetëvlerësimin e nxënësit etj., për t'u dhënë mundësi të gjithë nxënësve të shprehin sa më mirë arritjet e tyre.
- ☞ Mësuesit duhet të bëjnë kujdes për shmangien e mbingarkesës me detyra dhe teste të tepërta.
- ☞ Mësuesit e lëndëve të fushave: “Shoqëria dhe mjedisi”, “Arte”, “Teknologji dhe TIK”, “Edukim fizik, sporte dhe shëndet” etj., **NUK zhvillojnë teste, por detyra përmbledhëse me shkrim ose me gojë, në mënyrë që nxënësit të mos ngarkohen me teste për të gjitha lëndët.**
- ☞ Testi/detyra përmbledhëse nuk duhet të jetë i mbingarkuar dhe të synojë vlerësimin e të gjitha çështjeve që nxënësi ka zhvilluar. Nuk duhet të harrojmë që ky lloj vlerësimi është një ndër format e vlerësimit. Për monitorimin e progresit dhe për matjen e arritjeve të nxënësve, mësuesi përdor dhe format e tjera të vlerësimit.
- ☞ **Testi/detyra përmbledhëse do të realizohet gjatë kohës kur nxënësi zhvillon mësimin në klasë dhe jo gjatë mësimin online. Në këtë rast mund të përdoret shumë mirë orari me orë të njëpasnjëshme.**
- ☞ Mësuesit duhet të bëjnë kujdes në lidhje me numrin dhe llojin e detyrave të portofolit lëndor, duke shmangur ato lloj detyrash të cilat nxësin vetëm riprodhimin, nuk ushqejnë të menduarin kritik dhe krijues dhe krijojnë mbingarkesë të panevojshme të nxënësit. **Në këtë skenar portofoli i nxënësit për një periudhë mund të ketë vetëm 1 detyrë hulumtuese dhe një fazë të projektit.**
- ☞ **Në të gjitha lëndët, projekti kurrikular sugjerohet të jetë me shtrirje gjithëvjetoare në mënyrë që t'i japë mundësi dhe kohë të përshtatshme, hulumtimit dhe bashkëpunimit të nxënësve për realizimin e projektit.**

8.3 Vlerësimi i nxënësve në skenarin 3

Mësimi zhvillohet vetëm në distancë, në rast se situata e COVID- 19 përkeqësohet shumë në nivel kombëtar, në nivel lokal ose në nivel shkolle.

Në kushtet e zhvillimit të mësimin në distancë, vlerësimi i nxënësve do të mbështetet në këto parime:



Mirëqenia e nxënësve

Pandemia COVID-19 ka sjellë frikë, ankth dhe pasiguri te të gjithë. Fëmijët janë ata që i vuajnë më shumë këto pasoja. Në këto kushte qëllimi kryesor i vlerësimit duhet të jetë mirëqenia e nxënësve dhe jo vlerësimi i njohurive lëndore. Komentet dhe sugjerimet e mësuesve gjatë vlerësimit duhet të përqendrohen në nxitjen dhe në mbështetjen e fëmijëve për të nxënë. Nëpërmjet vlerësimeve, mësuesit duhet t'i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë situatën aktuale, duhet të japin komente pozitive për detyrat në të cilat nxënësit kanë shprehur ndjenjat dhe përjetimet e tyre, duhet të sqarojnë informacionet e gabuara ose keqkuptimet e nxënësve rreth pandemisë, duhet të shmangin detyrat që i ekspozojnë shumë nxënësit në mediat sociale, duhet të jenë të kujdesshëm për të mos i mbingarkuar nxënësit etj.

Nëse mësuesit janë mbështetës, të durueshëm, inkurajues, pozitivë dhe të vëmendshëm ndaj nxënësve, atëherë do të shmangen efektet negative psikologjike që mund të shkaktojnë pandemia tek ata.

Vlefshmëria dhe besueshmëria

Mësimdhënia bashkëkohore përqendrohet jo në përvetësimin e njohurive, por në pajisjen e nxënësve me kompetencat e nevojshme për të jetuar dhe punuar në shekullin XXI. Ky ndryshim duhet reflektuar edhe në procesin e vlerësimit. **Vlerësimi me në qendër nxënësin mund të bëhet edhe në një klasë virtuale.**

Në këtë situatë, mësuesit duhet të përdorin një larmi instrumentesh vlerësimi, të gjykojnë me kujdes për arritjet e nxënësve, të marrin në konsideratë angazhimin dhe gatishmërinë e

Gjatë mësimin në distancë, dy llojet e vlerësimit që rekomandohen më së shumti janë vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi i portofolit elektronik.

nxënësve në mësimin online, si dhe mirëqenien e tyre. Kështu ata mund të arrijnë të realizojnë një vlerësim të besueshëm dhe të vlefshëm bazuar në reflektime dhe sugjerime motivuese për nxënësit.

Vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi i portofolit elektronik janë të realizueshme dhe të besueshme, krijojnë mundësi për reflektim aktiv të mësuesve dhe të nxënësve, japin informacion për progresin e arritur, motivojnë nxënësit, shërbejnë për të përmirësuar mësimdhënien, si dhe shmangin ankthin dhe stresin e nxënësve.

Transparenca

Nxënësit kanë të drejtë dhe nevojë të njihen me kriteret me të cilat do të vlerësohen. Kjo garanton paanshmërinë dhe transparencën e vlerësimit dhe ndihmon të nxënësit. **Kriteret e qarta dhe të hapura ndihmojnë gjykimet profesionale, sigurojnë që vendimet të shqyrtohen nga të gjithë dhe të jenë të qëndrueshme.** Vlerësimi gjatë mësimin në distancë duhet të jetë transparent jo vetëm për nxënësit, por edhe për prindërit. Transparenca nuk ka për qëllim vetëm informimin e prindërve, por edhe bashkëpunimin dhe përfshirjen e tyre në mësimin e fëmijëve.

Etika

Vlerësimi i informacionit teorik ose i përmbajtjes mësimore lëndore do të krijonte mundësi që nxënësit të kopjonin. **Kopjimi dhe cenimi i të drejtës së autorit nuk janë etike. Për ta shmangur këtë mësuesit duhet të përqendrohen në detyra që lidhen me përpunimin e informacionit nga nxënësit duke zhvilluar mendimin kritik nëpërmjet analizës, vlerësimit, gjykit, sintezës, krijimit, zgjidhjes problemore, identifikimit të shkakut dhe të pasojës, dallimit të fakteve dhe të opinionëve etj.**

Gjithashtu, gjatë mësimin në distancë duhen shmangur rreptësisht përmbajtje, mesazhe dhe simbole që nuk përkojnë me misionin dhe detyrën e mësuesit, si dhe me normat etike të shoqërisë.

Gjithëpërfshirja

Gjatë mësimin në distancë, mësuesi duhet të jetë gjithëpërfshirës, fleksibël dhe të përdorë forma të përshtatshme vlerësimi për fëmijët me aftësi të kufizuara, për fëmijët romë dhe egjiptianë, për fëmijët që jetojnë në kushte të vështira ekonomike, për fëmijët që kanë mungesë të qasjes në teknologjinë e nevojshme për të mësuar në distancë (p.sh., internet të shpejtë ose kompjuter në shtëpi).

VLERËSIMI I NXËNËSVE NË SKENARIN 3

Mësimi zhvillohet vetëm në distancë, online me platformë të dedikuar akademi.al, në rast se situata e COVID- 19 përkeqësohet shumë në nivel kombëtar, në nivel lokal ose në nivel shkolle.

- ☞ Në dy javët e para të vitit shkollor 2020-2021, procesi i mësimdhënie-nxënies duhet përqendruar më së shumti në përsëritjen e njohurive dhe të aftësive të mësuara gjatë mësimit në distancë në vitin shkollor 2019-2020. Në këtë periudhë nuk ka vlerësime të mirëfillta të nxënësve, por vetëm reflektime për të nxitur dhe për të motivuar nxënësit në përsëritjen e tyre
- ☞ Komentet dhe sugjerimet e mësuesve gjatë vlerësimit duhet të përqendrohen në nxitjen dhe në mbështetjen e fëmijëve për të nxënë. Nëse mësuesit janë mbështetës, të durueshëm, inkurajues, pozitivë dhe të vëmendshëm ndaj nxënësve, atëherë do të shmangen efektet negative psikologjike që mund të shkaktojë pandemia tek ata.
- ☞ Vlerësimi i nxënësve gjatë mësimit në distancë duhet të nxjerrë në pah arritjet e tyre, në mënyrë që ata të inkurajohen të mësojnë me më shumë dëshirë. Ai duhet të konsiderohet si një mjet në ndihmë të nxënësve që ata të njohin më mirë aftësitë e tyre në të nxënë, të zhvillojnë e të përdorin talentet dhe aftësitë në mënyrë sa më të dobishme.
- ☞ Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta duhet të bëhet në mënyrë të tillë që t'u japë atyre mundësinë të demonstrojnë çfarë dinë dhe mund të bëjnë në përmbushje të rezultateve të të nxënit. Për këtë qëllim mësuesi duhet të përshtatë detyrat/veprimtaritë vlerësuese me mundësitë dhe nevojat që këta nxënës kanë.
- ☞ Metodatat dhe teknikat e përzgjedhura⁸ duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.
- ☞ Vlerësimi i nxënësve duhet të mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënit të programeve mësimore. Mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato rezultate që nuk janë në program.

⁸Për më shumë informacion mbi metodatat e vlerësimit të nxënësve gjatë mësimit në distancë, vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin e portofolit të nxënësit, referojuni “Udhëzuesit për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020”, MASR, ASCAP, Maj 2020. <https://www.ascap.edu.al/udhezues-per-vleresimin-e-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distance/>

- ☞ Metodrat, teknikat dhe strategjitë e vlerësimit të vazhduar duhet të jenë të shumëllojshme dhe të përfshijnë pyetjet dhe përgjigjet e nxënësve, pjesëmarrjen në diskutime, vlerësimin e detyrave të shtëpisë, vlerësimin e problemeve që shtrajnë zgjidhje të situatave të jetës së përditshme, vetëvlerësimin e nxënësit etj., për t'u dhënë mundësi të gjithë nxënësve të shprehin sa më mirë arritjet e tyre.
- ☞ Mësuesit duhet të bëjnë kujdes të mos mbingarkojnë nxënësit me detyra dhe, aq më tepër, me detyra që nuk mund të kryhen në kushtet e shtëpisë.
- ☞ Mësuesit duhet të bëjnë kujdes në lidhje me numrin dhe llojin e detyrave të portofolit lëndor, duke shmangur ato lloje detyrash të cilat nxisin vetëm riprodhimin, nuk ushqejnë të menduarin kritik dhe krijues dhe krijojnë mbingarkesë të panevojshme të nxënësit. **Në këtë skenar portofoli i nxënësit për një periudhë mund të ketë vetëm 1 – 2 detyra hulumtuese.**
- ☞ Në kushtet e zhvillimit të mësimin në distancë, në rast se nxënësit nuk mund të kryejnë projektet kurrikulare, mësuesi mund ta zëvendësojë projektin kurrikular që ishte parashikuar të realizohej në grup me një detyrë individuale krijuese, zbatuese, hulumtuese, duke pasur gjithmonë parasysh kushtet dhe mundësitë specifike të nxënësve. Nëse nxënësit kanë mundësi të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë online midis tyre, (kryesisht në arsimin e mesëm të lartë, por dhe në arsimin e mesëm të ulët) mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, mund të vijojnë me realizimin e projekteve kurrikulare të planifikuara në grup.

Në këtë skenar testi/detyra përmbledhëse nuk do të realizohet.

Vlerësimi i nxënësit në skenarin e mësimin në distancë përfshin tri variante, të cilat janë të kushtëzuara nga ecuria e situatës pandemike dhe janë të paraqitura si më poshtë:

Varianti 1: Kur mësimi në distancë zhvillohet përgjatë një periudhe dhe në dy periudhat e tjera vazhdohet me format e tjera të mësimin.

Varianti 2: Kur mësimi në distancë zhvillohet përgjatë dy periudhave dhe periudhën tjetër vazhdohet me format e tjera të mësimin.

Varianti 3: Kur mësimi në distancë zhvillohet përgjatë të tri periudhave.

Procedurat e vlerësimit të nxënësve për klasat 4-12⁹, sipas secilit variant paraqiten si më poshtë:

8.3.1 Varianti 1

Kur mësimi në distancë zhvillohet vetëm përgjatë një periudhe dhe në dy periudhat e tjera vazhdohet me format e tjera të mësimi.

Në këtë rast, për periudhën e mësimi në distancë, vlerësimi i nxënësit do të përfshijë:

-  vlerësimin e vazhduar;
-  vlerësimin e portofolit elektronik.

Vlerësimi me test ose me detyrë përmblledhëse për periudhën që mësimi zhvillohet në distancë NUK do të kryhet për shkak të pamundësisë së nxënësve për t'u lidhur online me mësuesit e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Në regjistër, në kolonën e vlerësimit me test/detyrë përmblledhëse do të shënohet NK (Nuk u krye) dhe kjo notë nuk do të llogaritet në vlerësimin vjetor për notën e testit/detyrës përmblledhëse.

Vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi i portofolit elektronik janë të realizueshëm dhe të besueshëm, krijojnë mundësi për reflektim aktiv të mësuesve dhe të nxënësve, japin informacion për progresin e arritur, motivojnë nxënësit, shërbejnë për të përmirësuar mësimdhënien, si dhe shmangin ankthin dhe stresin e nxënësve.

a) Vlerësimet vjetore përmbajnë:

-  Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar
-  Notën vjetore të vlerësimit me test ose me detyrë përmblledhëse (për dy periudhat që mësimi nuk zhvillohet në distancë)
-  Notën vjetore të vlerësimit të portofolit

b) Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:

- ⇒ Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NV_v), bazuar në **tri notat e tri periudhave**, duke gjykuar në mënyrë progresive ose me mesatare aritmetike.
- ⇒ Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmblledhëse (NT_p), bazuar në **rezultatit e dy periudhave** që mësimi është nuk është zhvilluar në distancë duke gjykuar në mënyrë progresive ose me mesatare aritmetike.
- ⇒ Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NV_p), bazuar në **tri notat e tri periudhave**, duke gjykuar në mënyrë progresive ose me mesatare aritmetike.
- ⇒ Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- ⇒ Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë.

⁹ Për klasat 1 – 3, parimet për vlerësimin e nxënësve do të ndiqen njësoj si për klasat e tjera, por duke zbatuar specifikat e vlerësimit të nxënësve që kanë këto klasa.

Shembull. Nëse një nxënës i klasës së tetë në lëndën e matematikës ka këto nota:

	NV _v	NT _p	NV _p
Periudha e parë ¹⁰	8	NK	9
Periudha e dytë	9	9	9
Periudha e tretë	9	8	9
Vlerësimet vjetore	9	8	9
Vlerësimi përfundimtar	$(NV_v \times 0.4) + (NT_p \times 0.4) + (NV_p \times 0.2) =$		

$$(9 \times 0.4) + (8 \times 0.4) + (9 \times 0.2) =$$

$$3.6 + 3.2 + 1.8 = 8.6 \approx 9$$

8.3.2 Varianti 2

Kur mësimi në distancë zhvillohet përgjatë dy periudhave dhe periudhën tjetër vazhdohet me format e tjera të mësimi.

Në këtë rast, për dy periudhat e mësimi në distancë vlerësimi i nxënësit do të përfshijë:

- 📁 vlerësimin e vazhduar;
- 📁 vlerësimin e portofolit elektronik.

Vlerësimi me test/detyrë përmblendhëse për dy periudhat që mësimi zhvillohet në distancë NUK do të kryhet për shkak të pamundësisë së nxënësve për t'u lidhur online me mësuesit e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Në regjistër, në kolonën e vlerësimit me test/detyrë përmblendhëse do të shënohet NK (Nuk u krye) dhe kjo notë nuk do të llogaritet në vlerësimin vjetor për notën e testit/detyrës përmblendhëse.

Vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi i portofolit elektronik janë të realizueshëm dhe të besueshëm, krijojnë mundësi për reflektim aktiv të mësuesve dhe të nxënësve, japin informacion për progresin e arritur, motivojnë nxënësit, shërbejnë për të përmirësuar mësimdhënien, si dhe shmangin ankthin dhe stresin e nxënësve.

a) Vlerësimet vjetore përmbajnë:

- 📁 Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar
- 📁 Notën vjetore të vlerësimit me test ose me detyrë përmblendhëse (për periudhën që mësimi nuk zhvillohet në distancë)
- 📁 Notën vjetore të vlerësimit të portofolit

¹⁰Për të ilustruar njehsimin e notës përfundimtare, në këtë shembull periudha e parë është konsideruar si periudha kur mësimi zhvillohet në distancë, ndërsa dy periudhat e tjera si periudha kur mësimi zhvillohet në formë tjetër. Njësoj do të vepohet edhe nëse periudhat janë e dyta ose e treta.

b) Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:

- ⇒ Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NV_v), bazuar në **tri notat e tri periudhave**, duke gjykuar në mënyrë progresive ose me mesatare aritmetike.
- ⇒ Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmblendhëse (NT_p), bazuar në **rezultatit e periudhës** kur mësimi nuk është zhvilluar në distancë.
- ⇒ Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NV_p), bazuar në **tri notat e tri periudhave**, duke gjykuar në mënyrë progresive ose me mesatare aritmetike.
- ⇒ Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- ⇒ Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë.

Shembull. Nëse një nxënës i klasës së tetë në lëndën e matematikës ka këto nota:

	NV_v	NT_p	NV_p
Periudha e parë ¹¹	8	NK	9
Periudha e dytë	9	NK	9
Periudha e tretë	9	8	9
Vlerësimet vjetore	9	8	9
Vlerësimi përfundimtar	$(NV_v \times 0.4) + (NT_p \times 0.4) + (NV_p \times 0.2) =$		

$$(9 \times 0.4) + (8 \times 0.4) + (9 \times 0.2) =$$

$$3.7 + 3.2 + 1.8 = 8.6 \approx 9$$

8.3.3 Varianti 3

Kur mësimi në distancë zhvillohet përgjatë të tri periudhave.

Në këtë rast, kur mësimi në distancë zhvillohet përgjatë të tri periudhave, vlerësimi i nxënësit do të përfshijë:

- 📁 vlerësimin e vazhduar;
- 📁 vlerësimin e portofolit elektronik.

Vlerësimi me test/detyrë përmblendhëse për të tri periudhat NUK do të kryhet për shkak të pamundësisë së nxënësve për t'u lidhur online me mësuesit e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Në regjistër, në kolonën e vlerësimit me test/detyrë përmblendhëse do të shënohet NK (Nuk u krye) dhe kjo notë nuk do të llogaritet në vlerësimin vjetor për notën e testit/detyrës përmblendhëse.

Vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi i portofolit elektronik janë të realizueshëm dhe të besueshëm, krijojnë mundësi për reflektim aktiv të mësuesve dhe të nxënësve, japin

¹¹Për të ilustruar njehsimin e notës përfundimtare, në këtë shembull periudha e parë dhe e dytë janë konsideruar si periudhat kur mësimi zhvillohet në distancë, ndërsa periudha e tretë si periudha kur mësimi zhvillohet në formë tjetër.

informacion për progresin e arritur, motivojnë nxënësit, shërbejnë për të përmirësuar mësimdhënien, si dhe shmangin ankthin dhe stresin e nxënësve.

a) Vlerësimet vjetore përmbajnë:

-  Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar
-  Notën vjetore të vlerësimit të portofolit

b) Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:

- ⇒ Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NV_v), bazuar në **tri notat e tri periudhave**, duke gjykuar në mënyrë progresive ose me mesatare aritmetike.
- ⇒ Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NV_p), bazuar në **tri notat e tri periudhave**, duke gjykuar në mënyrë progresive ose me mesatare aritmetike.
- ⇒ Mblidhen këto nota dhe pjesëtohen me dy. Nota përfundimtare në këtë rast del si mesatare e notës vjetore të vlerësimit të vazhduar dhe notës vjetore të portofolit të nxënësit.

Shembull. Nëse një nxënës i klasës së tetë në lëndën e matematikës ka këto nota:

	NV_v	NT_p	NV_p
Periudha e parë	9	NK	9
Periudha e dytë	8	NK	9
Periudha e tretë	8	NK	9
Vlerësimet vjetore	8	NK	9
Vlerësimi përfundimtar	$8 + 9 = 17 : 2 = 8.5 \approx 9$		

9 NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Mbyllja e shkollave në pranverën e 2020-ës ndikoi veçanërisht te nxënësit me aftësi të kufizuara. Këta nxënës e kishin pothuajse të pamundur të përfshiheshin në mësimin online. Planet e rihapjes së shkollave duhet të marrin parasysh nevojat e veçanta të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të zhvillojnë programe plotësuese për njohuritë dhe aftësitë kryesore që lidhen me periudhën mars-qershor 2020. Gjithashtu, shkollat:

- duhet të bashkëpunojnë me pushtetin vendor për të krijuar kushtet e përshtatshme për shëndetin dhe për sigurinë e nxënësve me aftësi të kufizuara;
- duhet të bashkëpunojnë me zyrën arsimore vendore për sigurimin e mësuesve ndihmës për të gjithë nxënësit me aftësi të kufizuara;
- duhet të realizojnë ose të bashkëpunojnë me institucione arsimore në varësi të MASR-së dhe me OJF, (pasi kanë marrë miratimin e MASR-së) që japin trajnime dhe kanë ekspertizë në fushën e arsimit, për trajnimin e mësuesve në lidhje me teknikat dhe strategjitë që duhen përdorur me nxënësit me aftësi të kufizuara gjatë mësimin online;
- duhet të informojnë prindërit në lidhje me shërbimet e ofruara dhe t'i orientojnë ata se si të punojnë me fëmijën e tyre. Drejtoria e shkollës të bashkëpunojë me këshillin e prindërve dhe me bordin e shkollës;
- duhet të bashkëpunojnë me prindërit për mënyrat e zbatimit të planit edukativ individual (PEI) në kushtet e zhvillimit të mësimin në shkollë ose në kushtet e shtëpisë (online). Në rast se mësimi do të zhvillohet i kombinuar (një javë në shkollë dhe një javë në shtëpi), sugjerohet që të merret miratimi i prindërve dhe të analizohet gjendja shëndetësore e nxënësit dhe më pas të vendoset nëse nxënësi do ta zhvillojë mësimin në shkollë apo në shtëpi. Megjithatë ofrimi i mësimin në shkollë dhe mbrojtja e shëndetit dhe e sigurisë së nxënësve me aftësi të kufizuara është prioritet, shkollat duhet të kujdesen që të mos krijojnë ndarje të panevojshme të nxënësve me aftësi të kufizuara nga bashkëmoshatarët e tyre;
- duhet të sigurojnë koordinim mes mësuesit lëndor, mësuesit kujdestar, mësuesit ndihmës, shërbimit psiko-social shkollor dhe prindërve për të punuar drejt përmbushjes së rezultateve zhvillimore dhe të nxënësit të vendosura në planin edukativ individual, si dhe të sigurohen për rishikimin e rezultateve sipas nevojave konkrete;
- duhet të bashkëpunojnë me institucione dhe me organizata të ndryshme për të siguruar ndihma, shërbime shtesë dhe teknologjinë e nevojshme për të plotësuar nevojat e veçanta të nxënësve me aftësi të kufizuara.

Rolin kryesor në punën me nxënësit me aftësi të kufizuara e ka mësuesi ndihmës. Pavarësisht situatës së krijuar nga COVID-19, mësuesi ndihmës:

- duhet të punojë për zhvillimin e potencialit intelektual, social-emocional dhe fizik të nxënësit;
- duhet të hartojë dhe të zbatojë planin edukativ individual (PEI) në bashkëpunim me mësuesin/t e klasës, psikologun dhe prindërit dhe atje ku ka mundësi me përfshirjen e vetë nxënësit;

- në bashkëpunim me mësuesin e klasës/lëndës, duhet të planifikojë ndërhyrjet për të plotësuar nevojat më prioritare të nxënësit për nxënësin, si dhe mangësitë e krijuara nga viti i kaluar shkollor, gjatë mësimit në distancë;
- për të mundësuar pjesëmarrjen e plotë të nxënësit në të gjitha orët mësimore, duhet ta asistojë atë gjatë procesit mësimor. Nëse mësimi do të bëhet online, mësuesi ndihmës duhet të bashkëpunojë me mësuesin/t e klasës, shërbimin psiko-social shkollor dhe me prindërit për të përmbushur rezultatet e përcaktuara në PEI;
- derisa procesi mësimor të zhvillohet në kushte normale, duhet të ketë fleksibilitet në lidhje me zbatimin e PEI-t, në varësi të specifikave të nxënësit dhe të rrethanave që lidhen me COVID-19;
- duhet të bashkëpunojë me mësuesin/t e klasës dhe me psikologun për vlerësimin e nxënësit sipas nivelit të arritjeve;
- duhet të raportojë në komisionin e shkollës mbi ecurinë e nxënësit dhe realizimin e rezultateve të PEI-t;
- duhet t'i informojë prindërit rregullisht për progresin mësimor dhe zhvillimor të nxënësit;
- duhet të kujdeset që nxënësi të mbajë maskën (kur është e mundur), të ruajë distancën fizike dhe të respektojë rregullat e higjienës.

10 VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR, PROVIMET KOMBËTARE PËR ARSIMIN BAZË DHE MATURA SHETËRORE

-  Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor (VANAF), provimet kombëtare të arsimit bazë (PKAB) dhe Matura Shtetërore (MSH) zhvillohen bazuar në programet orientuese për këto klasa. Programi orientues për vlerësimin e arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, programet orientuese për provimet kombëtare të arsimit bazë, si dhe programet orientuese për Maturën Shtetërore, për vitin shkollor 2020-2021, përgatiten nga ASCAP dhe publikohen në faqen e saj: <https://www.ascap.edu.al>.
-  Programet orientuese për lëndët e përfshira në provimet kombëtare përfshijnë njohuritë dhe shprehitë më të rëndësishme të programeve mësimore të këtyre lëndëve. Në varësi të situatës epidemiologjike dhe të skenarëve që do të ndiqen për zhvillimin e mësimin, do të kryhen përshtatjet e nevojshme për përfshirjen në programe të udhëzimeve specifike, të cilat u vijnë në ndihmë nxënësve, mësuesve dhe përdoruesve të tjerë të programeve orientuese.
-  Përgatitja e nxënësve për provimet kombëtare duhet të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.
-  Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimet kombëtare, është e rëndësishme që herë pas here përgjatë vitit shkollor mësuesi të zhvillojë testime të nxënësve me teste që mund t'i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e testeve të provimeve kombëtare. Programet orientuese japin udhëzime të detajuara në lidhje me strukturën e testit dhe llojet e pyetjeve.
-  Lidhur me mënyrën e zhvillimit të provimeve kombëtare do të bazoheni në udhëzimet përkatëse të MASR-së.

11 MBËSHTETJA DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE, DREJTUESVE DHE PJESËS TJETËR TË STAFEVE ARSIMORE

Për zbatimin e këtij udhëzuesi, si dhe për zhvillimin e mësimit gjatë vitit shkollor 2020 – 2021, MASR, ASCAP dhe institucione të tjera të varësisë do të përqendrohen në:

- hartimin e udhëzuesve në mbështetje të mësuesve, drejtuesve, nxënësve, prindërve, punonjësve psiko – socialë etj.;
- zhvillimin e vazhduar profesional të të gjithë mësuesve në sistemin e arsimit parauniversitar;
- mbështetjen e drejtuesve të rrjeteve profesionale për funksionin e rrjeteve profesionale dhe shpërndarjen e eksperiencave¹²;
- realizimin e videove mësimore për mësimin në distancë;
- realizimin e sondazheve për ecurinë e mësimit në distancë;
- trajnimin dhe informimin e vazhdueshëm të stafeve të shkollave rreth ecurisë së pandemisë;
- mbështetjen e nxënësve gjatë periudhave të tranzicionit, në rast se do të kemi kalime të menjëhershme nga një formë mësimi në një formë tjetër;
- orientimin drejt nevojave sociale dhe emocionale;
- bashkëpunimin e vazhdueshëm me prindërit dhe me komunitetin.

Për sa më lart lind nevoja e menjëhershme për trajnimin e drejtuesve, mësuesve, drejtuesve të rrjeteve profesionale, specialistëve të DRAP-eve, ZVA-ve në fushat e mëposhtme:

- Përdorimi i këtij udhëzuesi dhe zbatimi i skenarëve për procesin e mësimit.
- Zbatimi i protokolleve të shëndetit dhe të sigurisë, përfshirë mënyrën e kontrollit të simptomave, mbajtjen e distancës fizike, mbajtjen e maskës, pastrimin, larjen e shpeshtë të duarve, dhe se çfarë duhet bërë nëse dikush zhvillon shenja të COVID-19.
- Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie.
- Organizimi i një klase në internet.
- Metoda të mësimdhënies dhe të nxënies gjatë mësimit online.
- Metoda të vlerësimit të nxënësit gjatë mësimit online.
- Mbështetja e nxënësve në mësimin online.
- Komunikimi, bashkëpunimi dhe mentorimi i nxënësve gjatë mësimit online.
- Aspektet sociale dhe emocionale të të mësuarit online.
- Mirëqenia e nxënësve.
- Mbështetja e nxënësve me nevoja të veçanta gjatë mësimit online.
- Puna me nxënësit e talentuar në mësimin online.

¹² Gjatë vitit shkollor 2020-2021 puna me rrjetet profesionale do të vijojë normalisht duke përfshirë takime të drejtpërdrejta edhe takime online.

- Mësimi i bazuar në hulumtim/kërkim dhe mbështetja e nxënësve për të qenë aktiv.
- Komunikimi me prindërit.
- Siguria kibernetike, përdorimi i duhur dhe i përgjegjshëm i internetit (parandalimi i gjuhës së urrejtjes, i lajmeve të rreme, i sulmit në internet).
- Etj.

12 MBËSHTETJA DHE KOMUNIKIMI ME PRINDËRIT

Kthimi në shkollë në vjeshtën e 2020-ës paraqet për mësuesit dhe për drejtuesit e shkollave sfida të reja, si p.sh.: zbatimi i masave për distancimin fizik; pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve të shkollës; higjiena e duarve; përdorimi i maskave; mirëqenia dhe siguria shëndetësore, sociale dhe emocionale e nxënësve; plotësimi i orëve mësimore të humbura; përgatitja për mundësinë e rasteve të COVID-19 brenda shkollës dhe përreth saj etj. Në përballje me këto sfida, aleatët kryesorë të shkollës janë prindërit. Këtë vit shkollor, komunikimi dhe angazhimi i prindërve do të jetë më i rëndësishëm se kurrë. Nëse prindërit, shkollat dhe komuniteti do të punojnë së bashku dhe do ta mbajnë njëri-tjetrin të informuar, atëherë nxënësit do të jenë më të sigurt dhe më të suksesshëm.

Shkollat duhet të ofrojnë informacione për prindërit në mënyrë të vazhdueshme dhe me një gjuhë të qartë rreth shëndetit, sigurisë, procesit mësimor etj., dhe të marrin në konsideratë sugjerimet e tyre. Për këtë, shkollat mund të përdorin një rrjet të gjerë platformash, duke përfshirë postën elektronike, telefonatat, mediat sociale, postimet në internet etj. Më shumë se kurrë më parë, shkollat duhet të sigurojnë prindërit që ata po bëjnë më të mirën e mundshme për fëmijët e tyre.

Bashkëpunimi dhe informimi i prindërve duhet të nisë para se të fillojë viti i ri shkollor. Në procesin e hartimit të planeve në lidhje me organizimin dhe me rregullat e reja për parandalimin e përhapjes së virusit, shkollat duhet të përfshijnë sa më shumë prindër, përveç përfaqësuesve të këshillit të prindërve dhe të bordit të shkollës. Në fillim të vitit shkollor, çdo prind në shkollë duhet të jetë i informuar në lidhje me:

- orarin mësimor;
- mënyrën e organizimit të mësimi (në shkollë, të alternuar ose në kushtet e shtëpisë);
- procedurat ose rregullat e ardhjes dhe të largimit të nxënësve nga shkolla;
- transportin e nxënësve, në rast se distanca shkollë- shtëpi është e madhe;
- format dhe mjetet e komunikimit me mësuesit, sidomos nëse mësimi do të zhvillohet në kushtet e shtëpisë;
- teknikat dhe strategjitë e vlerësimit të nxënësve;
- rëndësinë e monitorimit dhe procedurat që duhen ndjekur në rast se fëmija ka simptoma të COVID-19 ose nëse ka pasur kontakte me persona të diagnostifikuar me COVID-19.

Gjatë vitit shkollor, prindërit duhet të informohen në mënyrë të qartë dhe të vazhdueshme në lidhje me ndryshimet në procesin mësimor dhe me rregullat e reja për parandalimin e përhapjes së COVID-19. Gjithashtu shkollat duhet të kenë një plan të gatshëm, në rast se ndonjë nga nxënësit nuk mund të vijoje mësimin në shkollë për shkak të kësaj situatë.

Shkollat mund të caktojnë një koordinator ose një pikë kontakti, i cili mund t'u përgjigjet pyetjeve nga nxënësit dhe nga prindërit në lidhje me situatën e COVID-19 dhe me planet e zbatuara nga shkolla.

Nga ana tjetër edhe prindërit duhet të ofrojnë mbështetje në krijimin e kulturës së re të shëndetit dhe të sigurisë në shkollë, si dhe në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Angazhimi i

prindërve është veçanërisht i rëndësishëm për nxënësit e arsimit fillor, pasi ata ende nuk kanë fituar pavarësi për të mësuar vetë. Në këto klasa, mbështetja e prindërve është e domosdoshme sidomos nëse mësimi do të bëhet online ose në kushtet e shtëpisë.

Disa nga përgjegjësitë e prindërve në lidhje me shëndetin, sigurinë dhe procesin e të nxënës të fëmijëve janë:

- Parandalimi i transmetimit të COVID-19 në shkollë duke i kontrolluar fëmijët e tyre çdo ditë për ndonjë simptomë të pranishme të virusit dhe duke i mbajtur ata në shtëpi nëse janë të sëmurë ose nëse kanë pasur kontakte të ngushta me një person të diagnostikuar me COVID-19.
- Pajisja e fëmijëve me maska dhe sigurimi që ata i mbajnë maskat edhe në mjediset e mbyllura jashtë shkollës.
- Komunikimi me mësuesit, drejtuesit e shkollave dhe autoritetet lokale, si dhe ndjekja e udhëzimeve shtetërore për shëndetësinë dhe sigurinë jashtë shkollës.
- Sigurimi i transportit të fëmijëve, në rast se është e mundur.
- Ndjekja në mënyrë të vazhdueshme e udhëzimeve dhe e detyrave që japin mësuesit për fëmijën.
- Njohja (kur është e mundur) e platformave ose e formave të tjera të komunikimit online ose të drejtpërdrejtë, me qëllim që të marrin udhëzimet dhe detyrat nga mësuesit.
- Krijimi i mundësisë (nëse është e mundur) dhe ndihmesa e fëmijës për t'u përfshirë në mësimin online me mësuesit dhe me shokët e klasës.
- Monitorimi i ecurisë së fëmijës duke i kërkuar një përmbledhje të shkurtër të mësimin ose të detyrave që ka kryer çdo ditë.
- Caktimi i një vendi të përshtatshëm dhe të qetë në shtëpi, ku fëmija mund të punojë në mënyrë të pavarur detyrat e tij dhe të lexojë çdo ditë.
- Komunikimi me mësuesit, në rast se fëmija ka pyetje ose ka nevojë për ndihmë dhe për mbështetje shtesë.
- Monitorimi dhe mbështetja e fëmijës në dorëzimin e detyrave sipas afateve të përcaktuara nga mësuesit.
- Krijimi i një regjimi të ekuilibruar për fëmijën, duke i lënë kohë për të lexuar, për të bërë detyrat, për të bashkëbiseduar, për të bërë aktivitete fizike, për të luajtur etj.



UDHËZUES PËR FILLIMIN E VITIT SHKOLLOR 2020-2021